



PEJË

Strategjia e veprimit

për komunitetin serb në komunën e Pejës

2009 - 2011

Strategjia e veprimit për komunitetin serb në komunën e Pejës 2009 - 2011



Publikuar nga:
OJQ "Syri i Vizionit"
Qendra Zejtare 64/B
30000 Pejë, Kosovë

Strategjia është hartuar nga OJQ "Syri i Vizionit" Pejë

Mendimet e shprehura në këtë dokument paraqesin pikëpamjet e autorëve dhe jo domosdoshmërisht edhe qëndrimet e Syri i Vizionit, Olof Palme Center dhe Komunës së Pejës.

Botimi i këtij dokumenti është mundësuar nga Olof Palme Center

Falënderime

Autorët e kësaj strategjie, organizata joqeveritare “Syri i Vizionit” falënderon gjithë bashkëpunëtorët, organizatat dhe individët që kanë ndihmuar në procesin e hartimit të këtij dokumenti.

Falënderim i parë është për Olof Palme Center për bashkëpunim të mirë dhe mbështetjen financiare që i ka dhënë këtij procesi.

Një falënderim i veçantë për komunën e Pejës, kryetarin Ali Berisha, drejtorin e administratës Naim Sahiti dhe shefin e Zyrës për komitete Sabahudin Ciriković, që prej fillimi janë interesuar për ecurinë e punës dhe realizimin e projektit.

Poashtu falënderojmë zyrtarin e nënzyrës për komunitete Slobodan Petroviq, që ka përcjellë procesin e hartimit të strategjisë si dhe Skënder Avdylin nga Drejtoria e shërbimeve publike, që ka ndihmuar në përllogaritjen e kostos së projekteve.

Falënderimi tjetër është për përfaqësuesit e komunitetit serb të Pejës, kryesuesit e fshatrave, përfaqësuesit e organizatave të këtij komuniteti si dhe të gjithë ata që kanë marrë pjesë në takimet e mbajtura nëpër fshatra dhe lagje të komunës së Pejës dhe që me kërkesat, sugjerimet dhe propozimet e tyre kanë kontribuar që ky dokument të jetë më i plotë në përmbajtje dhe më i pasur me ide e propozime.

Falënderojmë: përfaqësuesit e fshatrave të cilët kanë marrë pjesë në takimet e këshillit të përbashkët të fshatrave: Ilija Dashi, Miroslavka Simonović, Srgjan Dakiq, Jeremija Jeremiq, Miodrag Dashi, Millorad Jashović, Ranko Bakiq, Zoran Ashanin, Milija Llazović, Radovan Prashçević, Momçilo Saviq.

Falënderojmë anëtarët e fokus grupeve nëpër fshatra që kanë marrë pjesë në takime dhe trajnime: Bogdan Dashi, Krsto Xhavriq, Nebojsa Xhavriq, Milisav Dashi, Radovan Xhavriq (Brestovik); Dobra Ashanin, Luka Ashanin, Milivoje Ashanin, Milisav Bakiq, Elo Bakiq, Stanka Bakiq, Milojka Bakiq, Danijela Bakiq, Sanja Ashanin, Aleksandra Bakiq, Koviljka Bakiq (Ljevosha) Vuko Portiq, Millorad Jovanović, Miodrag Makeiq, Millan Krstović, Vesko Biçanin, Arangjell Ashanin, Zoran Dashi, Draginja Zdravković, Milica Kastratović, Marina Maksiq, Milena Zdravković, Tamara Petroviq, Slagjana Portiq, Dalibor Zdravković, Dushica Portiq, Mirjana Jeremiq, Dara Dimitrijeviq, Milica Jeremiq, Milunka Bokumiriq (Gorazhdevc); Gruica Jashović, Dejan Dashi, Slobodan Bukumiriq, Vujica Jashović, Radosh Jashović (Siga); Svetozar Lazović, Lubisha Llazović, Verica Llazović, Danillo Llazović, Radoslav Llazović (Llazović); Vladimir Saviq, Slagjana Jokiq, Rajka Milković, Arsenije Jokiq, Tushica Jokiq, Angjelka Jokiq, Milosh Milković, Petar Milković, Vinko Milković, Svetozar Zogović, Gordana Pavloviq (Belopojë); Millanka Prashqeviq, Verica Llazović, Dushanka Obradović, Predrag Obradović, Radmila Popović, Slobodan Popović, Lubica Llaban (Pejë).

Falënderim qendrës së gruas Briga ku janë mbajtur mbledhjet e përfaqësuesve të fshatrave në këshillin e përbashkët të komunitetit.

Autorët e këtij dokumenti ndjejnë të nevojshme të sqarojnë se nëse në tekstin e kësaj strategjie nuk është përfshirë puna ose aktivitetet e të gjithë atyre që kanë punuar në këtë komunitet, kjo është e paqëllimshme. Poashtu kërkojmë falje për të gjitha ata që mendojnë se nuk janë përfshirë sa duhet kërkesat dhe sugjerimet e tyre dhe komunitetit të tyre.

Shkurtesat:

AER	- Agjensioni Evropjan për Rinkonstruksion
DRC	- Danish Refugees Council (Këshilli danez për Refugjatë)
IOM	- International Orgazation for Migration
KEK	- Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	- Kosovo Force
KPA	- Agjensioni Kosovar i Pronës
MPDL	- Spanish NGO Movement for Peace
OJQ	- Organizatë Joqeveritare
OSBE	- Organizata e Sigurimit dhe Bashkëpunimit Evropjan
PTK	- Post - Telekom i Kosovës
RTK	- Radio Televizioni i Kosovës
SiV	- Syri i Vizionit
SHKA	- Shoqëri kulturore artistike
THW	- Teshnisches Hilfswerk
TMK	- Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UNDP	- United Nations Development Programme
UNHCR	- United Nations High Commissioner for refugees
UNMIK	- United Nations Mission in Kosovo

Të nderuar,

Komuna e Pejës me të gjitha strukturat e saj është zotuar se do të mobilizojë të gjitha resurset e veta në kahje të krijimit të një shoqërie shumëetnike. Komuniteti serb, i cili ka jetuar në këtë territor së bashku me të tjerët, është pjesë e kësaj shumëetnie dhe si i tillë pjesë e rëndësishme e strategjisë së krijimit të shoqërisë shumëetnike.

Ne si komunë jemi zotuar se do të punojmë së bashku me të gjithë në kahje të vlerësimit të nevojave të komuniteteve dhe asistimit të atyre nevojave.

Krijimi i një standardi jetësor, i cili gradualisht do të avancohet në standard evropian jetese, është një vizion i joni. Kjo ombrellë mbulon në vete të gjithë qytetarët e Komunës së Pejës, pa dallim.

Me nderime,

Ali Berisha
Kryetar i Komunës së Pejës



PËRMBAJTJA

5	Falënderime
6	Shkurtesat
7	Parathënie
9	Realizuesit
10	I. Hartimi i strategjisë
11	Çka është kjo strategji
11	Baza e hartimit të Strategjisë
11	Rruga që është ndjekur për hartimin e Strategjisë
12	Pjesëmarrësit në procesin e hartimit të Strategjisë
12	Përfshirja e komunitetit në hartimin Strategjisë
13	Përfshirja e komunës në hartimin e Strategjisë
13	Gjendja aktuale
13	Shtrirja e komunitetit serb në komunën e Pejës
14	Gjendja në të cilën jeton komuniteti serb
14	Hulumtimi i kryer nga "Syri i Vizionit" për gjendjen e këtij komuniteti në komunën e Pejës
15	Gjendja e familjeve
15	Gjendja e objekteve të banimit
15	Qasja në shërbimet publike
16	Qasja
16	Zbatimi i Strategjisë
16	Vështirësitë në realizimin e kësaj strategjie
18	II. Iniciativat dhe rekomandimet
19	Hyrje
20	Çështjet pronësore, të banimit dhe vendbanimet joformale
21	Edukim dhe rini
22	Punësimi dhe zhvillimi ekonomik
23	Shëndetësia dhe çështjet sociale
24	Siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi
26	Kultura, mediat dhe informimi
27	Të drejtat e femrave
28	III. Ndërhyrja në komunitet
29	Hyrje
30	Projektet për fshatin Bellopojë
34	Projektet për fshatin Sigë
36	Projektet për fshatin Gorazhdec
39	Projektet për lagjen Llazoviq
42	Projektet për komunitetin në Pejë
44	Projektet për fshatin Lëvoshë
47	Projektet për fshatin Brestovik
50	IV. Buxheti
51	Tabela Buxhetore
52	V. Foto
53	Fotografi nga takimet me komunitetet



Olof Palme Center Qendra Olof Palme

Olof Palme International Center punon në bashkëpunimin ndërkombëtar për zhvillim dhe krijimin e opinionit publik i cili ka të bëjë me çështjet ndërkombëtare politike dhe ato të sigurisë.

Palme Centre është themeluar në vitin 1992 nga Partia Social Demokrate e Suedisë, Konfederata e Sindikatës së Tregtisë dhe Sindikata Kooperative. Sot Palme Center ka 28 organizata anëtare brenda lëvizjes së punës.

Qendra punon sipas pikëpamjeve të Kryeministrit të ndjerë të Suedisë, Olof Palme, të cilat reflektohen në citimin e famshëm: "Politika po dëshiron diçka. Politikën Social Demokratike

po dëshirojnë ndryshime".

Bindja e Olof Palmes se siguria e përbashkët krijohet në bashkëpunim dhe solidaritet nëpërmes kufijve, përshkon aktivitetet e Qendrës.

Zotimi i këtyre organizatave anëtare është baza e aktiviteteve të Qendrës. Përveç organizatave themelore, ato përfshijnë edhe Shoqatën Edukuese të Punëtorëve, lëvizjen e banorëve dhe sindikatat individuale. Si lëvizje të popullarizuara dhe organizata vullnetare, ato përfaqësohen në të gjitha komunat e Suedisë dhe në shumë vende pune. Një individ nuk mund të jetë anëtar i Palme Center, por organizatat anëtare së bashku kanë mbi tre milionë anëtarë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar për zhvillim është i përqendruar në gjashtë rajone: Ballkan, Evropë Lindore dhe Rusi, Amerikë Latine, Lindje e Mesme, Azi Juglindore dhe Afrikë Jugore.

Palme Center dhe organizatat e saja anëtare përfshihen në afërsisht 450 projekte zhvillimore ndërkombëtare gjatë një viti. Ato shtrihen prej edukimit qytetar dhe strukturës organizative deri në projektet për të drejtat e njeriut dhe të pajtimit.

Qendra ka një kornizë marrëveshjeje me agjencinë Swedish International Development Co-operation Agency (SIDA), e cila financon projektet për zhvillim ndërkombëtar të organizatave anëtare. Shumica e projekteve zbatohen drejtpërsëdrejti nga organizatat anëtare, të cilat së bashku me partnerët e tyre lokal të bashkëpunimit janë përgjegjëse për planifikimin, inicimin dhe vlerësimin e projekteve. Kjo ndihmon që të krijohen lidhje shumë të fuqishme lokale. Qendra zbaton relativisht pak projekte të zhvillimit ndërkombëtar në vete, me përjashtim nga Ballkani.

Qendra gjithashtu administron fondin International Solidarity Fund (I-Fund), që është lëvizja e punës për solidaritet ndërkombëtar dhe bashkëpunim zhvillimor. Të gjitha mjetet e grumbulluara nga I-Fund përdoren ekskluzivisht për të mbështetur punën e zhvillimit të sindikatave dhe politikave.

Qendra është e bazuar në Stokholmin qendror.



OJQ "Syri i Vizionit"

Organizata Syri i Vizionit është regjistruar zyrtarisht si OJQ lokale në Shtator të vitit 2001, por ka filluar të funksionojë me herët që nga 1999 si Organizatë e Bazuar në Komunitet (CBO) në komunën e Pejës, duke bërë koordinimin dhe publikimin e revistës për të rinjtë në Kosovë me ndihmën financiare nga USAID-i. Që nga zanafilla, OJQ "Syri i Vizionit" ka arritë profesionalizëm në implementimin e projekteve të një spektri të gjere të projekteve të ndryshme, duke e dëshmuar veten si aktor i mirëfilltë i shoqërisë civile në Kosovë.

Përgjatë viteve të fundit, OJQ "Syri i Vizionit" ka zhvilluar partneritete të shumta me një spektër të gjere të organizatave lokale dhe ndërkombëtare, komunave dhe faktorëve tjerë në mbare Kosovën dhe Ballkanin si: USAID, IREX, DRC, CARE International, OSCE, Olof Palme, Swiss Labour Assistance, etj.

Qëllimi dhe Vlerat :

OJQ Syri i Vizionit kryesisht ka për qëllim promovimin e demokracisë lokale dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në Kosovë, e sidomos në regjionin e Pejës. Në përpjekjet e vazhdueshme për të implementuar praktika demokratike, OJQ Syri i Vizionit i jep rol të veçantë promovimit të qeverisjes së mire, përgjegjësisë, transparencës dhe pjesëmarrjes në sferat e ndryshme të shoqërisë civile.

Në praktike, çfarëdo projekti i implementuar nga OJQ Syri i Vizionit kërkon për të themeluar lidhje të vazhdueshme në mes të autoriteteve komunale dhe akter të shoqërisë civile në nivel individual ose institucional.

Objektivat e Programit :

Që nga fillimi, OJQ Syri i Vizionit ka artikuluar punën e saj rreth objektivave specifik si:

- Zhvillimi i përgatitjes dhe përhapjes së informative të besueshme dhe testuara tek qytetarët;
- Promovimi i vetëdijes publike lidhur me problemet urgjente sociale tek masa e gjere, nëpërmjet veprimeve që rrisin vetëdijen;
- Pajisja e qytetarëve me mjaft avokim/mbrojtje, si dhe aftësi për lobizim dhe punë ekipore/ të rrjetëzuar në mënyrë që ti praktikojnë të drejtat e tyre elementare dhe të mund të sfidojnë institucionet qeveritare;

Nga 2003, organizata është një nga partneret zyrtar të Web Portalit One World për Evropën Juglindore

Që nga 2004, OJQ "Syri i Vizionit" është bërë anëtar aktiv i Programi i Iniciativës Kosovare (KIP) Organizata merr pjesë në mënyrë aktive në iniciativat tjera për rrjetëzim në baza projekti siç është Platforma Pro Peace e lançuar në Kosovë me pjesëmarrjen e OJQ-ve lokale në 2005, Koalicionin për Parlament të Pastër, Koalicionin "Demokracia në Veprim", Rrjeti për Siguri, dhe Koalicioni për Bashkëpunim në mes Shoqërisë Civile dhe Qeverisë.



I. Hartimi i strategjisë

1.2 Baza e hartimit të Strategjisë

Strategjinë e veprimit në komunitetin serb është ne përputhje me dokumentet komunale, strategjitë komunale për kthim dhe integrim dhe me përkushtimin e Kuvendit Komunal të Pejës për veprimin në komunitetin serb. Strategjia mbështetet në orientimin e popullit dhe institucioneve të Kosovës për të ndërtuar një shoqëri të barabartë, për të përkrahur procesin e kthimit dhe integritit. Dokumenti poashtu është në përputhje edhe me dokumente tjera ndërkombëtare për trajtimin e pakicave dhe për qasje afirmative ndaj këtij komuniteti.

1.1 Çka është kjo strategji

Strategjia e veprimit për komunitetin serb në komunën e Pejës (në tekstin e mëposhtëm Strategjia) është dokument që synon të parashtrijë gjithë problematikën që ka komuniteti serb në komunën e Pejës. Ajo përmbledh nevojat dhe kërkesat e këtij komuniteti në lokalitete ku jeton në gjithë territorin e komunës, duke përfshirë problemet e tyre jetësore, kërkesat e komunitetit dhe zonës në të cilën jeton dhe parashtron orientimet e ardhshme të punës në këtë komunitet në këto tri vjet.

Si i tillë ky dokument është një bazë e mirë për komunën, donatorët dhe komunitetin në të ardhmen. Aty janë paraqitur gjithë problematikat, ndarë në sektorë të ndryshëm, janë ofruar zgjedhjet e mundshme dhe është bërë një përlllogaritje e përafërt e kostos së aksionit të veprimit në këtë komunitet. Në këtë mënyrë Strategjia përbën një plan aksioni dhe aktiviteti, ajo ngërthen në vete nevojat e komunës dhe komuniteteve.

Strategjia është hartuar nga OJQ "Syri i Vizioni" nga Peja në bashkëpunim me komunitetin, përfaqësuesit e fshatrave dhe lokaliteteve si dhe me komunën, zyrtarët komunalë për komunitete. Projekti është financuar nga Olof Palme Center.

Projekti është një pilot projekt që synon të mobilizojë dhe trajtojë komunitetin serb që të t'i ndihmojë ata në avokim më të mirë në mënyrë që ata të jenë pjesëmarrës në ndryshimet në jetën e tyre dhe në vendimmarrje. Me projektet që parasheh kjo strategji mendohet të përmirësojë kushtet e jetës së komunitetit serb, komunitet që në dhjetë vjetët e fundit në një pjesë të lokaliteteve ka jetuar i papërfshirë në zhvillimet në komunën e Pejës dhe pa shumë komunikim me komunitetin shumicë shqiptar.

Pasi kjo strategji është e hartuar në bashkëpunimin mes komunës, komunitetit serb dhe pjesëmarrësve tjerë me rëndësi në këtë proces, ky dokument do të jetë në shërbim të komunës, që ta shfrytëzojë sipas nevojës ose ta shndërrojë në dokument pune për komunën për periudhën në vazhdim, ose ta paraqesë para donatorëve që mund të shprehin interesim për të vepruar në komunitet.

1.3 Rruga që është ndjekur për hartimin e strategjisë

Strategjia është hartuar pas një pune shtatë mujore që OJQ Syri i Vizionit (SiV) ka bërë bashkë me komunitetin serb, përfaqësuesit e lokaliteteve të banuara nga komuniteti, aktivistëve dhe OJQ-ve të komunitetit si dhe Komunës së Pejës.

Fillimisht "Syri i Vizionit" ka vizituar komunitetin në të gjitha lokalitetet ku jeton ai dhe ka mbledhur të dhënat për jetën dhe gjendjen në të cilën jeton ky komunitet, për të pasur një pasqyrë më të mirë. Në mungesë të studimeve të mëparshme, në fazën e parë është bërë një hulumtim për të parë gjendjen me shifra dhe fakte konkrete. Hulumtimi është kryer në lokalitetet kryesore ku jeton komuniteti serb dhe ka qenë i fokusuar në pikat kryesore për të zbuluar gjendjen e familjeve dhe shtëpive në radhët e këtij komuniteti.

Pas kësaj në lokalitet më të mëdha në komunën e Pejës janë krijuar fokus grupet me pjesëtarë të komunitetit dhe është krijuar një strukturë e njerëzve në terren me të cilët "Syri i Vizionit" ka punuar dhe ka kontaktuar gjatë gjithë hartimit të projektit. Fokus grupet në fillim janë krijuar në fshatin Gorazhdec - tri grupe: ai i të rinjve, grave dhe burrave, në

Pejë, në fshatrat Brestovik, Sigë, Bellojë, Lëvoshtë dhe Llazoviq.
Me këto fokus grupe janë zhvilluar takime nëpër secilin fshat e lagje, në të cilat është diskutuar për temat sipas shtatë problematikave të caktuara. Kanë qenë shtatë sektorë sipas të cilave është diskutuar dhe janë kërkuar rrugët e zgjidhjeve: Çështjet pronësore, të banimit dhe vendbanimet joformale; Edukim dhe rini; Punësimi dhe zhvillimi ekonomik; Shëndetësia dhe çështjet sociale; siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi; Kultura, mediat dhe informimi; Të drejtat e femrave.
Pasi i është prezantuar komunitetit projekti, është kërkuar pjesëmarrja e tij aktive me sugjerimet dhe kërkesat, që ka ai, pasi në vendet e tyre anëtarët e komunitetit i dinë më së miri problemet dhe nevojat e veta.

Takimet janë mbajtura në secilin lokalitet, në lagje e në fshatra. Në këto takime janë marrë kërkesat e para, që përbëjnë bazën e parë për hartimin e planit të aksionit. Janë mbajtur dhjetëra takime me grupet, por edhe shumë takime me individuale dhe në grupe më të vogla me përfaqësues të komuniteteve.

Për të aftësuar komunitetin që në mënyrë sa më të mirë të dinë të parashtrojë kërkesat e veta, rrugët e prezantimit dhe avokimin e mëtejshëm, për përfaqësuesit e komunitetit janë mbajtur tri herë trajnime nga ekspertë për avokim, për draftimin e strategjisë dhe për hartimin e projekt-propozimeve.
Në trajnimin e parë (gjatë muajit gusht 2008) ata janë aftësuar për të identifikuar problemet në komunitetin ku jetojnë dhe të gjejnë mënyrat e avokimit deri në realizimin projekteve të tyre. Në trajnimin e dytë në muajin shtator 2008 përfaqësuesit e komunitetit serb janë aftësuar për hartimin e projekt-propozimeve. Trajnimi i tretë për draftimin e strategjisë është mbajtur në muajin shtator dhe me përfaqësuesit e komunitetit është dakorduar që të përgatisin ata vet dokumentet që do jenë pjesë e strategjisë.

Pas kësaj janë mbajtur takime të përbashkëta me përfaqësuesit e tri grupeve në fshatin Gorazhdec, grupit të të rinjve, burrave e grave, përfaqësuesit e Pejës, fshatrave Bellojë, Brestovik, Sigë, Lëvoshtë dhe Llazoviq, takime në të ashtuquajturin "këshill të përbashkët të komunitetit", me të cilët është punuar kapitull për kapitull në hartimin e strategjisë. Në këto takime kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të komunës nga nënzyra për komunitete, që ndodhet në fshatin Gorazhdec.

bazuar në gjithë materialin e mbledhur në këto dhjetëra takime me komunitetin si dhe kërkesat që në veti ka bërë secili lokalitet. Ajo është hartuar nga "Syri i Vizionit", ndërsa para botimit i është dhënë në shikim dhe diskutim përfaqësuesve të komunitetit në secilin lokalitet dhe komunës.

1.4 Pjesëmarrësit në procesin e hartimit të strategjisë

Projekti për hartimin e strategjisë së veprimit për komunitetin serb është udhëhequr nga OJQ "Syri i Vizionit" nga Peja, ndërsa është financuar nga Olof Palme Center. Strategjia në këtë gjendje është rezultat i punës së përbashkët që është bërë gjatë një viti mes "Syrit të Vizionit" dhe pjesëmarrësve tjerë, komunitetit, organizatave të komunitetit dhe komunës.

Komuniteti ka qenë i kyçur në mënyrë aktive dhe kreative gjatë gjithë kohës në projekt. Secili lokalitet ka pasur fokus grupet e veta, grupe prej 7-10 vetash, që në disa takime të mbajtura kanë dhënë sugjerimet dhe idetë e veta. Për të qenë më aktiv në pjesëmarrje përfaqësuesit e secilit lokalitet kanë ndjekur edhe trajnimet përkatëse për hartim të projekteve dhe për avokim. Sugjerime e mbledhura nga përfaqësuesit e komunitetit janë përfshirë në draftin e strategjisë, i cili pastaj përsëri në atë formë është analizuar dhe plotësuar me shtesat, sugjerimet dhe kërkesat e komunitetit.

Komuna e Pejës ka qenë poashtu gjatë gjithë kohës pjesë e punës, pasi ata kanë marrë pjesë në gjithë procesin, duke filluar nga informatat e para që janë marrë nga komuna, nëpër takimet në terren, në trajnime dhe deri në shikimin e variantit përfundimtar.

1.4.1 Përfshirja e komunitetit në hartimin strategjisë

Komuniteti kanë qenë i kyçur në mënyrë aktive dhe kreative gjatë gjithë kohës në projekt në disa mënyrë:

- Komuniteti është përfshirë direkt në hartimin e strategjisë gjatë takimeve të mbajtura nëpër lokalitetet. Në secilin nga lokalitetet që ka një numër të konsiderueshëm të banorëve janë mbajtur nga disa takime.
- Përfaqësuesit e komunitetit kanë marrë pjesë në takimet e "këshillit të përbashkët të

komunitetit", takime të mbajtura në Gorazhdec në të cilat është folur për problemet sipas fushave të përcaktuara.

- Gjatë hartimit të strategjisë janë takuar përfaqësuesit e komunitetit të mbledhur në fokus grupe të fshatrave, organizatat joqeveritare dhe grupimet tjera që përfaqësojnë komunitetet.

1.4.2 Përfshirja e komunës në hartimin e strategjisë

Që nga fillimi i zbatimit të projektit janë mbajtur kontakte me komunën. Kryetari i komunës në dy takimet e para është informuar për procesion e paraparë për hartimin e strategjisë dhe ai ka marrë rol aktiv për të ngarkuar personat përkatës për bashkëpunimin dhe ndihmën e mëtejme gjatë gjithë procesit. Pas kësaj bashkëpunimi kryesisht ka shkuar përmes Zyrës për komunitete-nënzyrës për komunitete në Gorazhdec. Ky bashkëpunim që ka qenë shumë i rëndësishëm për "Syrin e vizionit" që ka përfituar nga përvoja dhe puna e bërë më parë nga komuna në këtë komunitet. Përveç se ka ndihmuar në rolin këshillues, Zyra ka qenë pjesëmarrëse në shumicën e aktiviteteve që janë zhvilluar përgjatë rrjedhës së projektit, në fazën kur është prezantuar projekti, pastaj edhe në takime të "këshillit të komuniteteve" dhe në shikimin e draftit përfundimtar.

Strategjia në formën e draftit para shtypjes së saj i është dorëzuar komunës, kryetarit të komunës, zyrës për komunitete dhe nënzyres në Gorazhdec për të dhënë sugjerimet, për të plotësuar apo shtuar diçka në formën përfundimtare.

1.5 Gjendja aktuale

1.5.1 Shtrirja e komunitetit serb në komunën e Pejës

Komuniteti serb para luftës ka banuar pothuaj se në çdo pjesë të qytetit dhe fshatrave. Në disa fshatra afër qytetit të Pejës ky komunitet ka përbërë edhe shumicën e popullsisë si për shembull në Gorazhdec, Bellopojë, Levoshë, Sigë dhe Brestovik, ndërsa në fshatra tjera kanë qenë të përziera dhe komuniteti serb ka bashkëjetuar me komunitetet tjera si në Poçestë, Zllapek, Vitomiricë, Babiq, Krstovc, Treboviq etj. Edhe pse një numër i madh i këtij komuniteti ka jetuar në qytet, shumica e tyre edhe sot posedojnë tokat bujqësore të kualitetit të lartë në fshatrat apo në periferi të qytetit të Pejës dhe ky komunitet njihet si shumë punëtor dhe i vyeshëm posaçërisht në blegtori dhe bujqësi.

Gjatë luftës së fundit përveç fshatit Gorazhdec, i cili kurrë në histori nuk dihet që ka lëshuar pragun, gjithë tjerët janë shpërngulur jashtë Kosovës në Mal të Zi apo Serbi, ose janë zhvendosur në veri të Kosovës. Kthimi ka filluar nga viti 2003 dhe ka qenë në fillim i organizuar kryesisht në vendet ku ky komunitet ka përbërë shumicën e popullsisë si në Bellopojë p.sh. dhe ku siguria ka qenë në nivel më të lartë. Ndërsa tani çdo ditë më tepër po intensifikohet edhe kthimi spontan e po ashtu edhe në vendet ku gravitimi i këtij komuniteti ka qenë në një numër më të vogël si p.sh. nëpër lagjet e ndryshme të qytetit si dhe fshatrat përreth etj.

Tani përveç fshatit Gorazhdec që s'ka qenë i zhvendosur, kthimi i suksesshëm është realizuar edhe në Bellopojë, Sigë, Brestovik, Lëvoshë, e kthim të qëndrueshëm ka edhe në zonë urbane me të kthyer që janë të shpërndarë nëpër qytet, e një numër i konsiderueshëm në lagjen Llazoviq të qytetit. Në fshatrat Brestovik, Sigë dhe Lëvoshë në pesë vjet janë ndërtuar 130 shtëpi, në lagjen Llazoviq janë rindërtuar 20 , kurse në Bellopojë 73 shtëpi, shumë nga të cilat megjithatë mbesin të pabanuara.

Përderisa në Kosovë nuk ka shifra zyrtare të regjistrimit të popullsisë momentalisht në dispozicion ka shifra të ndryshme. Në këtë dokument për krahasime dhe nevoja të parashtrimit të gjendjes janë përdorur shifrat e përafërta nga UNHCR si një institucion kredibil, kompetent dhe i paanshëm, si dhe shifrat që ka nxjerrë vet në terren "Syri i Vizionit".

1.5.2 Gjendja në të cilën jeton komuniteti serb

Ky komunitet jeton në lokalitete të ndryshme të qytetit, në pjesën urbane e po ashtu edhe në zonat rurale. Ndryshimet politike kanë bërë që ata të humbin vendet e punës që i mbanin në administratë, polici e gjykata, kurse privatizimi i fabrikave ka lënë punëtorët pa mundësi kthimi në vendet e punës. Tash një pjesë e mirë e tyre janë të pa punë dhe marrin asistencë sociale ose pensione. Kohët e fundit dallohen iniciativat e ndryshme të punimit të tokave pjellore që i posedojnë duke u përshtatur me gjendjen ekzistuese të papunësisë së madhe në komunë. Në sektorin e bujqësisë ata nga donatorë vendorë dhe të huaj janë ndihmuar shumë me mjete dhe makineri si dhe me fondin blegtoral. Sa i përket infrastrukturës ky komitet para luftës ka qenë i favorizuar me investime nga shteti, dhe kryesisht ka rrugë të asfaltuara objekte shkollash, ambulanca, shtëpi kulture, etj. Përveç në fshatin Gorazhdec ku ka më shumë shtëpi të vjetra, në vendet tjera ku janë kthyer, ata kanë shtëpi të reja, në të cilën jetojnë familje me numër të vogël anëtarësh. Në fshatrat tjera jashtë Gorazhdecit jetojnë kryesisht kryefamiljarë, të moshuar që mbajnë shtëpitë dhe tokat e tyre, kurse të rinjtë gjithnjë e më pak pranojnë të kthehen në mungesë të perspektivës edhe për shkak të varfërisë në Kosovë, edhe për shkak se nuk e gjejnë perspektivën në jetën e fshatit.

Sa i përket organizimit të jetës në komunitet ekzistojnë dy struktura të pushtetit, ato kosovare dhe ato të Serbisë. Kështu ekzistojnë strukturat kosovare të arsimit, shëndetësisë, higjienës por edhe të njëjtat të Serbisë. Shumë herë është e njëjta strukturë e njerëzve që është pjesë e të dy sistemeve të financimit dhe ndarjes së përgjegjësisë. Gjatë vjetëve të kaluara këto struktura herë janë forcuar, herë janë dobësuar, por kanë qenë gjithnjë të pranishme. Kjo posaçërisht është e dallueshme në fshatin Gorazhdec. Komuniteti ka përfituar nga të dy strukturat e pushtetit në paga, projekte, etj. edhe pse nuk i ka kryer obligimet ndaj asnjërit. Komuniteti nuk paguan tatim në pronë, nuk paguan rrymën, ujin dhe shërbime tjera. Organizimi shoqëror i komunitetit është në nivel të ultë. Një pjesë e mirë e këtij komuniteti edhe në mungesë të përvojës, edhe për mosnjohje të rrjedhave dhe ndryshimeve që kanë ndodhur vjetëve të fundit në Kosovë, ka mbetur jashtë përfshirjes në çfarëdo rrjedhe të jetës shoqërore në komunë. Arsyet politike kanë pasur gjithnjë një ndikim në përfshirjen e këtij komuniteti në jetën shoqërore dhe vazhdojnë të kenë përsëri

ndikimin e vet. Nga strukturat komunale dhe qendrore të qeverisjes kosovare ka pasur ftesa të vazhdueshme për t'u përfshirë në procesin politik në Kosovë dhe në komunën e Pejës. Dialogu ndëretnik dhe integrimi i komunitet mbeten një kërkesë e vazhdueshme në të cilën duhet të punojë shoqëria kosovare. Viteve të fundit edhe në kuadër të vet komuniteti ka një qasje më aprovuese në këtë drejtim.

1.6 Hulumtimi i kryer nga "Syri i Vizionit" për gjendjen e këtij komuniteti në komunën e Pejës

OJQ "Syri i Vizionit" gjatë muajve qershor e korrik të vitit 2008 ka bërë një hulumtim për gjendjen e komunitetit serb në komunën e Pejës. Intervistat e bëra nga hulumtuesit nga OJQ "Syri i Vizionit" kanë mbledhur informacione për gjendjen e familjeve të këtij komuniteti dhe objekteve të banimit. Hulumtimi është kryer në shtatë lokalitetet e banuara me pjesëtarë të komunitetit serb: Pejë, Llazoviq, Gorazhdec, Lëvoshtë, Sigë, Brestovik e Bellopojë. Në këto vende janë intervistuar 100 familje, nga të cilat intervistuesit kanë marrë të dhënat e përgjithshme dhe ato në tematika të veçanta. Të intervistuarit u janë përgjigjur pyetjeve për numrin e anëtarëve në familje, moshën dhe gjininë e tyre, gjendjen ekonomike-punësimin, të ardhurat, pasurinë dhe pronat. Poashtu në pyetësorët për gjendjen e shtëpive/objekteve të tyre banimit gjatë intervistimeve janë mbledhur të dhënat për madhësinë e shtëpive dhe hapësirën për jetesë për familjet, kohën dhe kushtet e ndërtimit, pajisjen e shtëpive me pajisjet, etj. Intervistimi jep një pasqyrë të plotë të gjendjes dhe kushteve në të cilat jeton komuniteti, një pasqyrë kaq të hollësishme nuk e ka bërë asnjë institucion më parë, duke nxjerrë të dhëna të saktësuara për komunitetin dhe kushtet në të cilat jeton. Hulumtimi ka një mangësi lidhur me numrin banorëve për faktin se intervistuesit kanë dhënë jo gjendjen reale në familjet e tyre, por kanë përfshirë aty edhe anëtarë të familjes që momentalisht jetojnë jashtë Kosovës.

1.6.1 Gjendja e familjeve

Në këto shtatë lokalitete të komunës janë kryer 100 intervista me qytetarë që jetojnë aty. Rezultati ka treguar se nga familjet e intervistuarra del se familja mesatare ka përafërsisht 5.04 anëtarë për familje, 58% e familjeve të intervistuarra e përbëjnë mosha prej 24 deri 64 vjet.

Sa i përket nivelit të shkollimit hulumtimi nxjerr në pah se 58 përqind e popullatës ka vetëm arsim fillor, kurse 9 përqind kanë arsimim të lartë.

Në temat për punësimin rezultati është se 80 përqind e të intervistuarve nga mosha 18-64 nuk punojnë, 2 përqind deklarohen se janë vetë punësuar, kurse të punësuar janë 18 përqind.

Në të hyrat familjare 61 përqind vijnë nga rrogat, 25 përqind nga asistenca sociale, kurse 24 përqind nga diaspora.

Nga shumat e deklaruara për hyrjet mujore del që 48 përqind kanë të ardhura prej mbi 100 e deri mbi 300 euro, 36 përqind kanë më pak se 100 euro në muaj.

Automjete të motorizuara në posedim të familjeve të intervistuarra janë deklaruar që 80 përqind nuk kanë në posedim asnjë automjet.

1.6.2 Gjendja e objekteve të banimit

Sa i përket gjendjes së banimit, intervistimi ka nxjerrë në pah se gjatë luftës 46 përqind e shtëpive kanë pasur dëmtime të kategorinë V, kurse 35 përqind e shtëpive të tyre nuk janë dëmtuar ose kanë pësuar dëmtime të vogla. Pas luftës janë të ndërtuara 11 përqind e shtëpive kurse tjerat para kësaj periudhe. Shumica e shtëpive (45 përqind) janë njëkatëshe, kurse nga të intervistuarit 75 përqind e shtëpive kanë kualitet të mirë ndërtimi. Sa i përket shfrytëzimit 20 % e shtëpive janë me më shumë se 150 metra katrore.

Sa i përket lejeve të ndërtimit, 97 përqind deklarohen që kanë leje ndërtimi, kurse vetëm 3 përqind nuk kanë pëlqim urban në shfrytëzim.

Sa i përket shërbimeve komunale ka një qasje të kufizuar për familjet e këtij komuniteti. 99 përqind të komunitetit shfrytëzojnë drurin për ngrohje. Intervistimi nxjerr në pah se 84 përqind nuk kanë telefona fiks, por 74 përqind shfrytëzojnë telefona mobil; 84 përqind janë të lidhur me ujësjellësin e qytetit kurse 81 përqind që nuk kanë kanalizime por përdorin gropat septike. Në këtë komunitet 55 përqind përdorin deponi ilegale për grumbullimin e

mbeturinave. Për dallim nga shërbimet, përgjigjja ndaj obligimeve është e vogël: 99 % e të intervistuarve deklarojnë se nuk paguajnë tatim në pronë.

1.7 Qasja në shërbimet publike

Varësisht nga lokaliteti ku jetojnë pjesëtarët e komunitetit serb kanë qasje në shërbimet publike të institucioneve të Kosovës, por edhe atyre të Qeverisë së Serbisë në Kosovë. Në disa vende ata kanë qasje në shërbimet publike të të dy pushteteve.

Ata ndjekin mësimet në shkollat e veçanta për serbët në fshatin Gorazhdec që financohet nga qeveria e Kosovës dhe nga Qeveria e Serbisë. Por shkolla e ciklit të ultë në Brestovik ka nxënëse edhe serbë edhe shqiptarë.

Shërbimet shëndetësore poashtu komuniteti serb i ka në ambulancat e lokaliteteve ku jeton, në fshatrat fqinje dhe në qytetin e Pejës. Sa i përket shërbimeve sociale pjesëtarët e komunitetit gëzojnë të njëjtat kushte si gjithë qytetarët e Kosovës. Lidhur me punësimin në institucionet komunale dhe shtetërore, komuniteti ka një numër të të punësuarve që kalon rreth 50 vetë në institucione të ndryshme komunale, plus të punësuarit në strukturat e pushtetit serb në Kosovë.

Në aspektin e përfaqësimit, serbët për shkak të mos daljes në zgjedhjet lokale nuk kanë përfaqësues në Kuvendin Komunal të Pejës, kurse në Kuvendin e Kosovës, 20 vende janë të rezervuara për komunitet pakicë në Kosovë-dhjetë për serbë.

Problemet e banimit, pronave dhe vendbanimeve joformale nuk janë probleme me të cilat ndeshet komuniteti. Vendbanimet kanë kryesisht infrastrukturë të zhvilluar në krahasim me fshatrat tjera.

Çështja e sigurisë paraqet një problem i cili është tashmë i tejkaluar në këtë komunitet kudo që jeton në komunën e Pejës. Pjesëtarët e këtyre komuniteteve kanë lirinë dhe sigurinë si dhe e shprehin pa ndonjë pengesë përkatësinë tyre etnike dhe fetare.

Komuniteti ka një radio lokale, ndërsa informimin tjetër e marrin nga mediat nga Beogradi. Për problematikat e tyre është shkruar mjaft nga media në gjuhën shqipe, me një qasje që posaçërisht vjetëve të fundit kryesisht është pozitive dhe afirmuese.

1.8 Qasja

Strategjia i qaset komunitetit në mënyrë afirmative. Qëllimi i kësaj strategjie është të afirmojë veprimin pozitiv në raport me komunitetin, në përputhje me orientimet evropiane për veprimin me komunitetet pakicë si dhe në koordinim me politikat e Qeverisë së Kosovës karshi komuniteteve pakicë në Kosovë.

Nga ana formale, problematikave të komuniteteve strategjia iu ka qasur në dy mënyrë: me qasjen në përgjithësi dhe sipas lokaliteteve të veçanta. Qasja e parë ka të bëjë me kërkesat dhe problematikat që kanë të bëjnë me komunitetin në përgjithësi kudo që jeton brenda komunës së Pejës. Në këtë pjesë bëhet fjalë për tematika të tilla që s'lidhen me lokalitetin por janë nevoja të përbashkëta për të gjithë komunitetin. Aty hyjnë kërkesat për përdorimin e gjuhës serbe, informimin, përfaqësimin politik, procesin e kthimit dhe integritet, etj. nga të cilat përfiton gjithë komuniteti në secilin lokalitet, përfshirë edhe lokalitetet më vogla në të cilat ka vetëm disa familje.

Strategjia është e mbështetur në debatet me komunitetet orientuar në shtatë tema kryesore të konsideruara si më të rëndësishme për komunitetet:

- Shtëpitë, çështjet pronësore, vendbanimet joformale
- Edukimi dhe rinia
- Punësimi dhe zhvillimi ekonomik
- Shëndetësia dhe çështjet sociale
- Siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi
- Kultura, mediat dhe informimi
- Të drejtat e femrave

Qasja sipas lokaliteteve të ndryshme ka të bëjë me projekte të veçanta. Kryesisht më të shpeshta në këtë pjesë janë projektet për infrastrukturën, projektet e infrastrukturës, bujqësisë, zhvillimit ekonomik, etj.

Në këtë pjesë gjatë hartimit të strategjisë bashkë me komunitetin "Syri i Vizionit" ka tentuar të bëjë edhe përlllogaritjen e përafërt të koston së implikimit buxhetor për projektet e veçanta. Në këtë mënyrë këto kërkesa të komunitetit kanë marrë formën e mini projekteve, në të cilat sipas një modeli të përbashkët janë përcaktuar disa kërkesa si kostoja e përafërt e llogaritjes e çmimit, objektivat dhe qëllimet, përfituesit, etj. Këto të dhëna janë konsideruar si pasqyrë e parë për t'u paraqitur para komunës dhe donatorëve për të matur mundësinë e angazhimit financiar.

1.9 Zbatimi i strategjisë

Ky dokument u adresohet të gjithë institucioneve, organizatave dhe atyre që janë të interesuar për të punuar me komunitetin serb në komunën e Pejës. Megjithatë, në radhë të parë Strategjia është hartuar për të qenë në dispozicion të komunës dhe komunitetit, për nevojat e planifikimit, ndërhyrjes në këtë komunitet dhe për të qenë në dispozicion për donatorët.

Strategjia në formën e tillë të hartuar ofron një pasqyrë të gjendjes në terren, kërkesat e komunitetit dhe jep sugjerime për projektet dhe drejtimet e mundshme të zhvillimit dhe investimit në periudhën trevjeçare në vazhdim. Ajo mund të shfrytëzohet nga zyrtarët komunalë në takimet me donatorët të cilët mund të shohin vendin se ku mund të kyçen për të ndihmuar komunën dhe komunitetin.

Me përcaktimin e kërkesave/ projekteve Strategjia jep edhe një përlllogaritje të përafërt të koston së ndërhyrjes, kështu që paraqet një tregues të mirë të nevojave të implikimeve buxhetore për vetë komunën ose donatorët, në mënyrë që ata të kenë mundësi të matin mundësitë e tyre dhe angazhimit të tyre në komunitete.

Ajo është një dokument në dispozicion posaçërisht për vetë komunitetin, përfaqësuesit e tyre, qoftë në institucionet politike, qoftë të shoqërisë civile për të kërkuar projekte dhe zhvillimin e komunitetit. Ajo do të jetë një dokument i rëndësishëm që pasqyron gjendjen e tërësishme të komunitetit të tyre, mundësitë dhe perspektivat.

1.10 Vështirësitë në realizimin e kësaj strategjie

Autorët e strategjisë e kuptojnë që gjitha rekomandimet dhe sugjerimet që dalin nga ky dokument nuk mund të plotësohen përnjëherë, as në një periudhë të shkurtë. Ato mbesin si orientime të vazhdueshme për institucionet dhe shoqërinë në një periudhë afatmesme dhe afatgjate. Por disa nga kërkesat sipas sektorëve dhe disa nga projektet dallohen për urgjencën me të cilën duhet ndërhyrë në to. Prioritet në këtë aspekt paraqitet nevoja për të ndërhyrë në sektorë të punësimit, aktivizimit e rinisë, ngjalljen e jetës në fshatrat ku është bërë kthimi, shtimin e të kthyerve në pjesën urbane dhe ruajtjen e pasurisë. Këto kërkojnë ndërhyrje të shpejtë, ndërsa edhe sektorët tjerë janë poaq të rëndësishëm dhe me nevojën që sa më parë të veprohet në to.

Autorët e strategjisë janë të vetëdijshëm për disa vështirësi që do të ndikojnë në realizimin e kësaj strategjie. Vështirësi kryesore në këso raste janë mungesa e mjeteve financiare për plotësimin dhe jetësimin e nevojave që ka komuniteti. Komuniteti serb në lokalitetet ku jeton kanë nevojë për ndryshime të mëdha qoftë në mënyrën e jetës, qoftë në raport me fqinjët e vet. Mundësia reale financiare e institucioneve qendrore dhe lokale, buxhetit dhe shoqërisë kosovare, janë shumë të kufizuara, ndërsa nevojat janë të mëdha dhe kërkesat vijnë nga të gjitha komunitetet dhe nga të gjitha kategoritë.

Poashtu është e ditur se numri i donatorëve, ku hyjnë fonde dhe organizata ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe në komunën e Pejës, është zvogëluar, prandaj edhe mundësia e përkrahjes për projektet e komunitetit është më e vogël tash.

Një tjetër vështirësi është nga vet komuniteti, mënyra e tij e organizimit, ndërhyrja e politikës dhe mungesa e dëshirës për të marrë pjesë në jetën politike dhe shoqërore të komunës. Me mungesën e përfaqësimit në pushtetin lokal komuniteti shkëput lidhjet me komunën, institucionet dhe donatorët dhe kjo ndikon në zbatimin e kësaj strategjie në të cilën parashihet bashkëpunimi i të gjithë faktorëve. Probleme mund të ketë për faktin se gjendja ekonomike e sociale e komunitetit, mungesa e zhvillimit, përçarja nga ndikimi i politikës dhe mungesa e elitës kulturore që do i printe komunitetit për të identifikuar nevojat e tij dhe rrugët e zgjedhjes. Komuniteti nuk është i organizuar sa duhet, nuk ka konkurrencë e garë mendimesh, projektesh politike e idesh. Sektori i shoqërisë civile ndonëse është prezent nuk është forcuar sa duhet.

Vështirësi në këtë aspekt paraqet fakti se pjesëtarët e komunitetit janë shpërndarë nëpër lokalitete të ndryshme që shumë herë janë larg nga njëri tjetri, në bashkësi të vogla që shumë herë nuk e kalojnë numrin e disa familjeve në një fshat. Në këtë mënyrë komunikimi dhe ndërveprimi brenda komunitetit është i paktë dhe mundësia e organizimit të përbashkët është e vogël. Në këto familje kryesisht jetojnë të moshuar dhe pak të rinj.

Sa i përket projekteve për punësim vështirësitë shtohen nga fakti se në Kosovë dhe komunën e Pejës papunësia është shumë e madhe, numri i vendeve të punës që mund të hapen është shumë i vogël dhe kjo bën të vështirë përfshirjen e pjesëtarëve të këtij komuniteti në projektet për punësim.

Vështirësia e fundit që duhet përmendur është për faktin se Strategjia është jobligative në

kuptimin që nuk ka ndonjë organ përgjegjës i cili do zbatonte këtë dokument. Në këtë aspekt institucionet dhe donatorët vendosin vet për mënyrës se sa dhe si do të plotësojnë rekomandimet që dalin nga ky dokument. "Syri i Vizionit" inkurajon institucionet që të shfrytëzojnë sa më shumë këtë dokument dhe të plotësojnë aq sa munden nga kërkesat që dalin nga ky dokument.



II. Iniciativat dhe rekomandimet

2.1 Hyrje

Strategjia i qaset komunitetit në dy mënyrë: me qasjen në përgjithësi dhe sipas lokaliteteve të veçanta. Qasja e parë ka të bëjë me kërkesat dhe problematikat që kanë të bëjnë me komunitetin në përgjithësi kudo që jeton brenda komunës së Pejës. Në këtë pjesë bëhet fjalë për tematika të tilla që s'lidhen me lokalitetin por janë nevoja të përbashkëta për të gjithë komunitetin. Aty hyjnë kërkesat për përdorimin e gjuhës serbe, informimin, përfaqësimin politik, procesin e kthimit dhe integritimit, etj. nga të cilat përfiton gjithë komuniteti në secilin lokalitet, përfshirë edhe lokalitetet më vogla në të cilat ka vetëm disa familje.

Strategjia është e mbështetur në debatet me komunitetin orientuar në shtatë fushat kryesore të konsideruara si më të rëndësishme për komunitetin. Ato janë:

1. Çështjet pronësore, të banimit dhe vendbanimet joformale
2. Edukimi dhe rinia
3. Punësimi dhe zhvillimi ekonomik
4. Shëndetësia dhe çështjet sociale
5. Siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi
6. Kultura, mediat dhe informimi
7. Të drejtat e femrave

Në të vërtetë në shumë raste, problematikat me të cilat përballlet komuniteti serb janë e përgjithshme, për të gjitha komunitetet. Me të njëjtën problematikë në shumicën e rasteve përballlet edhe vet komuniteti shumicë shqiptar, siç janë çështjet e punësimit, zhvillimit ekonomik, bujqësisë, shërbimet joaq të mira shëndetësore, çështjet e ndihmës sociale, etj.

Por ka edhe problematika që janë të veçanta për komunitetin serb sikurse çështjet e lëvizjes, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit politik, çështjet e ndërmarrësisë ekonomike në kuptimin e tregut, kultura e informimi, të drejtat e banimit dhe shfrytëzimit të pronës, etj.

Bazuar në takimet me komunitetin dhe nevojat që kanë paraqitur vet përfaqësuesit e komunitetit disa sektorëve u është dhënë më pak vëmendje në këtë strategji, duke u përqendruar në sektorë tjerë ku është menduar se kontributi mund të jetë më i madh për vet komunitetet.

2.2 Çështjet pronësore, të banimit dhe vendbanimet joformale

Përshkrimi i gjendjes: Komuniteti serb në komunën e Pejës në pjesën më të madhe jeton në zona rurale. Përqendrimi i popullatës varet nga përbërja dhe struktura etnike e fshatrave dhe nga ecuria e kthimit në dhjetë vjetët pas luftës në Kosovë. Shikuar për nga numri, shumica e banorëve megjithatë jetojnë në fshatin Gorazhdec. Në këtë vend ata kanë jetuar pa shikëputje që prej luftës, pa u larguar asnjëherë nga Kosova. Pesë shtëpi gjithsej janë të dëmtuara nga lufta dhe ato vazhdojnë të jenë në gjendje të tillë edhe sot, pasi në fshat nuk ka pasur proces të rindërtimit. Fshatrat tjera kanë kaluar nëpër djegiet e luftës së vitit 1999 dhe në to bashkë me procesin e kthimit të organizuar që është udhëhequr nga disa institucione, është dashur të bëhet edhe rindërtimi i shtëpive. Në fshatrat Brestovik, Sigë dhe Levoshë në pesë vjetjanë ndërtuar 130 shtëpi, në lagjen Llazoviq janë rindërtuar 20 tjera, kurse në Bellopojë 73 shtëpi. Shumica nga këto shtëpi janë të pabanuara. Një pjesë e tyre janë nxjerrë në shitje edhe pse shtëpitë janë bërë për të stimuluar procesin e kthimit. Komuniteti ngrit problemin e disa shitjeve joligjore të shtëpive, që bëhen me dokumente të falsifikuara dhe që kanë krijuar probleme në komunitet. Me ndërtimin e këtyre është kryer pjesa dërmuese e shtëpive e shtëpive që kanë qenë para luftës në këto fshatra. Edhe pse ka edhe një numër prej dhjetëra shtëpive të pandërtuara, çështja e rindërtimit për momentin nuk paraqitet si prioritet dhe si nevojë e ngutshme për komunitetin, por mbetet si synim në të ardhmen.

Në pjesën urbane të qytetit të Pejës gjendja është më specifike. Pasi nuk ka ndonjë studim për gjendjen e objekteve të banimit në pronësi të serbëve në qytetin e Pejës, nuk dihet se çka dhe si është gjendja në këtë sektor. KPA megjithatë ka të dhëna për pronat në komunën e Pejës e që kryesisht janë banesa (edhe pse ka edhe prona tjera) nga të cilat shumica janë në pronësi të serbëve. Kërkesat në këtë agjensi, sipas të dhënave të muajit dhjetor 2008, i kanë paraqitur pronarët e 3279 pronave, nga të cilat kjo agjensi i ka zgjidhur 995 raste. Në rastet e paraqitura dhe të nxitura nga KPA në administrim janë vënë në Pejë 589 prona, ndërsa me qira janë lëshuar 113 tjera.

Në qytetin e Pejës nuk janë ndërtuar shtëpi për të kthyerit në këtë fazë pasi është menduar se kthimi mund të jetë më lehtë i realizueshëm në zona rurale. Por në zonën urbane të Pejës paraqiten problemet me pronat e banimit kolektiv në pronësi të serbëve, shumica e të cilave ka qenë e

uzurpuar dhe shfrytëzuar pa leje. Këto banesa iu janë nënshtruar dëmtimit, ndërsa një pjesë e tyre nga shfrytëzuesit e rinj vazhdojnë të mbahen në shfrytëzim pa asnjë të drejtë dhe ata refuzojnë t'i lirojnë ato. Agjensioni Kosovar i Pronës punon në menaxhimin e tyre dhe momentalisht ai është i vetmi organ përgjegjës për çështjet pronësore banesore në Kosovë, porse kapaciteti i saj për të mbuluar një numër të madh banesash dhe për t'i mbajtur ato në kontroll është i vogël.

Për dallim nga zona urbane, në zonat rurale çështja e pronësisë së shtëpive dhe pronave paraqet një problem më të vogël, pasi pronësia është më e përcaktuar. Por në këto lokalitete problem paraqitet realizimi i të drejtës së shfrytëzimit të kësaj prone. Banorët e Gorazhdecit, e posaçërisht ata të Llazoviqit kanë problem shfrytëzimit të pronës ose të përfitimit vjetor nga toka, pasi ato i punojnë dhe i vjelin fqinjët e tyre pa asnjë lloj kompensimi.

Në kuptim të statusit të lokaliteteve të banuara me serb në komunën e Pejës, zonat që janë përfshirë në këtë strategji, paraqesin zona formale dhe problemi i vendbanimeve joformale nuk është problem momental i këtij komuniteti.

Probleme ka edhe me pajisjen e qytetarëve me dokumente, qoftë ato të lëshuara nga Unmik, e tash edhe këto që po lëshohen nga organet e Republikës së Kosovës.

Iniciativat ekzistuese:

Shumë donatorë kanë punuar në rindërtimin e shtëpive: Qeveria italiane, Qeveria holandeze, AER, Qeveria e Serbisë, Qeveria e Kosovës, Komuna e Pejës, Erik Shalpen, THW, Bergamo per il Kosovo, IOM, Evropian Perspective, MPDL, etj. dhe për pasojë për një pjesë të mirë të këtij komuniteti është zgjidhur çështja e banimit.

Agjensioni Kosovar i Pronës (KPA) është agjensioni që merret me çështjet pronësore dhe zgjidh problemet e pronësisë me mandatin për kërkesat që rrjedhin nga lufta e vitit 1999 në lidhje me pronën e paluajtshme private, që përfshin pronën bujqësore dhe komerciale. KPA bën pranimin dhe regjistrimin e kërkesave specifike për pronën e paluajtshme private, zbatimin e vendimeve përfundimtare ligjore dhe bën administrimin e pronave të braktisura.

Komuna e Pejës në një projekt që për herë të parë udhëhiqet nga vetë ajo e që financohet nga Bashkimi Evropian, Qeveria e Kosovës dhe UNDP vetëm në pjesën e parë të vitit 2009 do ndërtojë edhe 25 shtëpi për komunitetin serb në Komunën e Pejës.

Peja është komuna e parë në Kosovë që ka hartuar Planin ideor urbanistik dhe zhvillimor, plan ky i vetmi i pranuar edhe nga Qeveria e Kosovës. Në këtë qytet ka filluar puna për Hartimin e Strategjisë Implementuese për Planifikimin Rregullues Urban. Gjatë tri vjetëve të ardhshme pritet të kryhet hartimi i planeve rregulluese të hollësishme për të gjitha qytetin dhe më këtë do të sqarohet veprimi direkt i punës nëpër secilën lagje dhe në të njëjtën kohë do të verifikojë më afër nevojën e banorëve për legalizimin e shtëpive dhe ndërtimeve të mundshme në të ardhmen.

Rekomandime për veprime të mëtejme:

- ? *KPA të forcohet dhe të jetë më aktive në mbrojtjen e dhe menaxhimin e pronave*
- *Policia e Kosovës poashtu të ndihmojë realizimin e mandatit të KPA lidhur me pronat e serbëve*
- *të kërkohen donatorë tjerë për të vazhduar rindërtimin e shtëpive*
- *të ketë një mbikëqyrje nga komuna për shitblerjen e pronave në mënyrë që të mos ketë keqpërdorime dhe falsifikime që bëjnë të mundur që tokën ta shesin mashtruesit, që i shkakton probleme komunitetit*
- *të përkrahet dhe të ndihmohet pajisja e qytetarëve me dokumentet kosovare*

2.3 Edukimi dhe rinia

Përshkrimi i gjendjes: Në fshatin Gorazhdec ka shkollë fillore dhe të mesme në gjuhën serbe. Aty ndjekin mësimin nxënësit e fshatit, por edhe nxënësit nga fshati Bellopojë. Mësimi zhvillohet vetëm në gjuhën serbe sipas planprogrameve të Republikës së Serbisë kurse mësimdhënësit paguhen edhe nga buxheti i Qeverisë së Kosovës edhe nga ai i Qeverisë së Serbisë. Shkollat kanë kaudrin e mjaftuar ndërsa janë tri drejtime në shkollën e mesme: ekonomike, teknike dhe gjimnaz.

Shkollimi në lokalitetet tjera në të cilat jetojnë serbët për shkak të strukturës së popullsisë, paraqitet specifike në këto lokalitete. Përveç fshatit Gorazhdec që ka numër të madh të banorëve dhe të rinjve, në fshatrat tjera dhe në qytetin e Pejës ka një numër fare të vogël të të rinjve serbë. Për këtë arsye në këto lokalitete nuk ka gati aspak nxënës dhe deri në fazë tjetër kur planifikohet dhe dëshirohet një kthim më i madh dhe më i qëndrueshëm, çështja e arsimit nuk paraqitet si çështje e prioritetit. Në fshatin Brestovik ekziston një

shkollë fillore e ciklit të ultë, paralele e ndarë e shkollës "7 shtatori" të Vitomiricës. Aty mësimin e ndjekin edhe nxënësit në gjuhën shqipe edhe në gjuhën serbe, edhe pse numri i nxënësve serb aty është shumë i vogël, këtë vit ka vetëm 4 nxënës.

Në fshatrat tjerë dhe në qytetin e Pejës momentalisht nuk ka nxënës nga komuniteti serb, por ata priten në të ardhmen nëse procesi i kthimit zhvillohet me sukses dhe nëse kthehen anëtarët tjerë të familjeve që jetojnë momentalisht në Pejë. Në fshatin Bellopojë ka pasur një objekt shkollë, që ishte objekt i ndërtuar para pak më shumë se 10 vjetëve, por ai është djegur në trazirat e marsit 2004. Po të ndërhyhet me ndërtimin çatisë dhe riparimit të mureve ekzistuese, ky objekt mund të kthehet në shfrytëzim për komunitetin dhe për nxënësit.

Sa i përket arsimit parashkollor për nxënësit nga komuniteti serb në fshatin Gorazhdec ka një klasë parashkollore me 28 nxënës në kuadër të shkollës së fshatit.

Sa i përket arsimit të lartë, studentët nga ky komunitet ndjekin studimet në Universitetin në Mitrovicë që punon me planprogramet e Republikës së Serbisë. Ka afër 50 studentë të tillë momentalisht.

Në Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë ka disa drejtime në gjuhën boshnjake, por në to deri më taninuk ka asnjë student serb edhe pse ka vende për ta. E njëjta gjendje është edhe në katër shkolla të mesme të komunës së Pejës.

Autorët e kësaj strategjie mendojnë se në një të ardhme sa më të shpejtë shkollat multietnike duhet të jenë synim i shoqërisë dhe institucioneve arsimore në këtë komunë.

Gjendja e të rinjve në këtë komunitet varet nga kushtet e rrethanat që ka jetuar komuniteti në dhjetë vjetët e kaluara. Përveç fshatit Gorazhdec në fshatrat tjera ka pak ose aspak të rinj, pasi ata nuk gjejnë perspektivë në Kosovë dhe ose largohen në Serbi ose në vendet perëndimore. Jeta politike dhe shoqërore që zhvillohet brenda komunitetit serb është e tillë që nuk ofron shumë mundësi për kyçe të të rinjve. Ata janë pak të kyçur në politikë, ndërsa subjektet politike që veprojnë brenda komunitetit nuk kanë degët e forumeve rinore brenda partisë.

Në fshatin Gorazhdec ka një shoqatë të të rinjve me emrin "Metohija", kurse më parë ka ekzistuar edhe një tjetër organizatë joqeveritare me emrin "Krug". Ato kanë zhvilluar aktivitete me të rinjtë e komunitetit dhe me disa projekte të përkrahura nga donatorët kanë ndikuar në forcimin e veprimit rinor brenda komunitetit.

Iniciativat ekzistuese:

Në fshatin Brestovik të Pejës në vitin 2005 është ndërtuar një shkollë në të cilën nxënësit serbë kanë refuzuar të shkojnë për dy vjet, pasi kanë preferuar që të shkojnë në shkollën e Gorazhdecit. Këtë vit shkollor aty ka filluar mësimi edhe në gjuhën serbe.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë, që është pjesë e Universitetit të Prishtinës, ka hapur studimin në drejtimit përkatëse edhe në gjuhën boshnjake. Fakulteti ka planprogramet dhe kuadrin e duhur të profesorëve për studim në këtë gjuhë. Deri më tani aty janë regjistruar vetëm studentë të komunitetit boshnjak por në të ardhmen synimi është që në këtë fakultet të ketë edhe studentë nga komuniteti serb. Edhe shkollat e mesme të qytetit të Pejës kanë mësimin dygjuhësh. Klasa në gjuhën boshnjakeka në Gjimnaz, në Shkollën teknike, në Shkollën e mjekësisë dhe në Shkollën ekonomike.

Tek të rinjtë e komunitetit serb ka një strukturë të organizatave rinore që me ndihmën e disa donatorëve kanë zhvilluar disa projekte që mund të ndikojnë në ndryshime në jetën e të rinjve të këtij komuniteti. Këtë vit është aktivizuar edhe një herë klubi futbollistik "Omladinac" nga Gorazhdec. Ai për herë të parë ka marrë pjesë në kampionatin e organizuar nga strukturat serbe në Kosovë, edhe pse asnjë ndeshje nuk e ka zhvilluar në Gorazhdec.

Rekomandime për veprime të mëtejme:

- të përkrahet krijimi i shkollave multietnike
- të gjenden fonde për riparimin e shkollës në fshatin Bellopojë
- të ndërtohet një aneks në Shkollën Ekonomike për nxënësit në gjuhën serbe ???
- të inkurajohet pjesëmarrja e të rinjve në politikë
- të përfshihen të rinjtë në aktivitete kulturore e sportive
- të përkrahet realizimi i projekteve për organizimin dhe fuqizimin e rinisë, duke filluar nga organizatat rinore, klubet sportive, etj
- të zhvillohen aktivitete sportive dhe kulturore të të rinjve serbë dhe komuniteteve tjera, si psh. turne futbollit, mbrëmje rinore, ekspozita artsitike, etj.

2.4 Punësimi dhe zhvillimi ekonomik

Përshkrimi i gjendjes:

Komuniteti serb që jeton momentalisht në komunën e Pejës përbën një komunitet të vogël në kuadër të popullsisë së përgjithshme të komunës. Ata janë 1306 banorë në një komunë me rreth 150 mijë banorë edhe pse në të kaluarën ata përbënin një komunitet shumë më të madh me disa mija banorë. Numri i atyre që punojnë nuk është shumë i madh, pasi që jo vetëm ky komunitet, por i gjithë rajoni përballen me papunësi të madhe ku një pjesë e mirë e popullatës së komunës jeton në kushte të vështira dhe varfëri. Sipas të dhënave që "Syri i Vizionit" ka mbledhur nga gjendja në terren rezulton se në institucionet shtetërore punojnë një numër prej së paku 53 vetë nga komuniteti serb. Në administratën komunale dhe tre sektorët kryesorë të saj punojnë 32 pjesëtarë të këtij komuniteti (arsim 26, administratë 3 dhe shëndetësi 3), 8 në polici dhe 13 në shërbimet: KEK 8, ujësjellës 1 dhe 4 PTK. Poashtu ka një numër më të madh të punësuar në institucionet me financim nga Qeveria Serbe. Në këtë grup ka që marrin paga të dyfishta ose që kanë vetëm pagën nga Serbia. Aty hyjnë sektorët e financimit buxhetor arsimit, shëndetësisia etj. për të cilat nuk të dhëna e as studim. Këto të ardhura ndikojnë në përmirësimin e gjendjes ekonomike të komunitetit.

Pjesa tjetër kryesisht janë të papunë. Në kuadër të komunitetit ka edhe ndonjë ndërmarrës privat të biznesit, por biznesi i tyre kryesisht kufizohet brenda lokalitetit dhe komunitetit të vet. Në komunitet ka projekte për biznese që do lidheshin me këtë komunitet, si fjala bie për prodhimin e "suxhukut nga Peja" që mund të gjente treg shitjeje në Serbi, për ndërtimin e varrezave dhe lapidarëve, për një grup muzikor, etj. porse ato si ide janë më afër iniciativave për ndërmarrësi private.

Pjesa më e madhe e komunitetit serb në të kaluarën, para luftës, ka qenë tërësisht e punësuar në sektorin shtetëror dhe janë mbajtur nga pagat, kurse të ardhurat shtesë kanë marrë nga tokat dhe pronat e veta që kryesisht shtrihen në zona të mira dhe pëlleshme dhe me kanale ujitje. Por në periudhën në vazhdim, orientimi i tyre mbetet bujqësia dhe blegtoria. Në vitet e kaluara ka pasur shumë projekte për të ndihmuar posaçërisht zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë, ndihma me mjete teknike të punës dhe me fondin e bagëtive. Nga kjo ndihmë disa kanë shkuar në favor të komunitetit në fshatrat përkatëse, por edhe

disa raste kanë shkuar për përfitime personale. Për menaxhimin e këtyre të mirave të përbashkëta të dhuruara dhe të fituara nga komuniteti, krijimi i kooperativave, ose ndonjë forme të bashkimit të fermerëve është e nevojshme dhe nga komuniteti shihet si mundësia dhe për të evituar keqpërdorimet dhe për t'i paraprirë zhvillimit ekonomik.

Iniciativat ekzistuese:

Një numër prej së paku 53 pjesëtarëve të këtij komuniteti që tashmë është punësuar në institucionet e ndryshme shtetërore komunale dhe rajonale. Janë 32 të punësuar në komunë (administratë, arsim e shëndetësi), 8 në polici dhe 13 në shërbimet KEK, ujësjellës dhe PTK. Kjo paraqet një bazë të mirë për fillim për punësimin e këtij komuniteti.

Policia e Kosovës dhe Trupa Mbrojtëse e Kosovës vazhdimisht kanë paraqitur ftesën për pjesëtarët e këtij komuniteti që të punësohen në këto institucione.

Organizata dhe institucione të ndryshme kanë ndihmuar banorët e fshatrave për bujqësi. Në fshatin Gorazhdec për të qenë në shërbim të komunitetit janë dhuruar traktorë nga organizatat ndërkombëtare Care e Concern dhe një tjetër nga Qeveria e Serbisë. Banorëve të Brestovikut dhe Sigës nga një traktor ua ka dhuruar edhe Qeveria e Kosovës, e poashtu nga një traktor ka ardhur edhe nga Manastiri i Deçanit, dhuratë nga një donator norvegjez. Një traktor për Sigën dhe një për Brestovikun ka dhënë edhe IOM-i, bashkë me furnizimin me karburant, ndërsa pajisje shtesë bujqësore për përpunimin e tokës ka dhënë edhe KFOR-i italian. Në fshatin Brestovik edhe një kombajnë është dhuruar nga European Prespektive. Në fshatin Bellopojë Manastiri ka dhënë një traktor, e ky fshat ka përfituar nga një traktor edhe nga IOM dhe European Prespektive. Në fshatin Llazoviq një traktor është dhuruar nga KFOR-i italian. Projekte ndihme ka pasur edhe në Lëvoshë me fond blegtoral.

Organizata të ndryshme vendore e të huaja poashtu kanë dhuruar krerë lopësh dhe bagëti tjera më të imta. Pavarësisht mënyrës se si janë menaxhuar pajisjet, se a janë përdorur ato për gjithë komunitetin, apo për një grup të vogël, apo pavarësisht nëse fermerët i kanë mbajtur lopët apo i kanë shitur menjëherë, kjo përkrahje ka krijuar një potencial për zhvillimin e bujqësisë në këtë komunitet.

Në fshatin Gorazhdec organizata e grave "Briga" ka një linjë prej tetë makinave qepëse, stafin e aftësuar 30 gra dhe lokalitë përkatës që janë krijuar më përkrahjen e organizatës Concern. Po të vihej në veprim dhe të

punësonte një numër të grave poqëse gjendet ndonjë kontratë përkatëse për ta. Poashtu ekziston një ëmbëltore, një sallon frizerësh dhe një repart i madh i ish fabrikës që mund të shfrytëzohen në projekte të punësimit dhe zhvillimit.

Rekomandime për veprime të mëtejme:

- *institucionet me financim nga buxheti i Kosovës në radhët e tyre të punësojnë pjesëtarë të këtij komuniteti*
- *të inkurajohen të rinjtë serbë që të punësohen në institucionet e Kosovës*
- *posaçërisht duhet punësuar pjesëtarët e këtyre komuniteteve në projektet që kanë të bëjnë me këtë komunitet*
- *punësimi i një roje pylli në Brestovik a Sigë*
- *të përkrahen projektet për ferma, mini biznese të cilat do mbaheshin nga pjesëtarët e këtij komuniteti*
- *të përkrahet hapja e kooperative ose bashkimit të fermerëve në zonat me këtë komunitet*
- *të përkrahet zhvillimi i bujqësisë në fshatra*

2.5 Shëndetësia dhe çështjet sociale

Përshkrimi i gjendjes: Pjesëtarët e komunitetit serb kanë shërbime shëndetësore në ambulancat e afërta në fshatrat ku jetojnë, kurse ata që jetojnë në zonën urbane kanë shërbime të përbashkëta me popullatën shumicë. Për raste tjera të shërbimeve nga shëndetësia sekondare, ata shërbimet i marrin në Spitalin e Pejës dhe të Mitrovicës. Fshatrat Gorazhdec, Brestovik, Lëvoshë dhe Bellopojë kanë ambulancat e veta. Qendra mjekësore në fshatin Gorazhdec ka ekip mjekësor prej katër mjekësh, stafin e infermiereve dhe shërbime tjera. Tri ambulancat tjera punësojnë dhe plotësohen nga dy infermiere me vizitat që u bëhen nga mjekët e Pejës dhe ata të Gorazhdecit nga një herë në javë.

Banorët e fshatit Gorazhdec kërkojnë që në vendin e tyre të hapet një stacionar me disa shtretër, në të cilën do trajtoheshin rastet më të thjeshta dhe rastet që kanë nevojë për

shtrim urgjent në pritje për dërgim në ndonjë spital tjetër. Për këtë ka vend dhe kuadër të mjaftueshëm.

Sa i përket shërbimeve sociale duhet pasur parasysh se shoqëria kosovare nuk ofron shumë në politikën sociale. Numri i vogël i atyre që përfitojnë këtë ndihmë vjen për shkakun se kriteret për të përfituar janë shumë të vështira dhe të paktë janë ata që mund t'i plotësojnë. Në muajin nëntor 2008 Qendra për punë sociale e Pejës ka evidentuar gjithsej 1595 përfitues në komunën e Pejës. Nga ta përfitues janë 20 familje me 45 anëtarë të komunitetit serb.

Iniciativat ekzistuese:

Institucionet vendore dhe ndërkombëtare gjatë dhjetë vjetëve të kaluara kanë realizuar dhjetëra projekte infrastrukture për përmirësimin e kushteve të jetës përfshirë rrugë, ujësjellës e kanalizime, etj. në të gjitha lokalitetet ku jeton komuniteti serb, që ka ndikuar në kualitetin e jetës në këto lokalitete.

Ka disa ambulanca të cilat ofrojnë shërbimet primare shëndetësore, bashkë me vizitat e mjekëve së paku një herë në javë në fshatrat Brestovik, Lëvoshë e Bellopojë. Në Qendrën mjekësore të Gorazhdecit ka ekip prej katër mjekësh dhe stafi tjetër mjekësor.

Mjekët nga komuna e Pejës vizitojnë këto ambulanca një herë në javë dhe mundësojnë vizitat mjekësore në ambulancat e fshatit.

OJQ e grave "Briga" ka një projekt të financuar nga Intersos me të cilin aktivizohen rreth 40 pensioniste nga të gjitha fshatrat e Pejës, në aktivitete, takime dhe biseda të përbashkëta.

Ka një ndihmë minimale sociale për 20 familjet më të varfra që plotësojnë kushtet e pacaktuara me ligj, për përfitimin e ndihmës sociale.

Në ambulancat e financuara nga Qeveria e Serbisë shërbime mjekësore janë falas dhe sigurim shëndetësor, për dallim nga ato të menaxhuara nga institucionet kosovare në të cilat pacientët participojnë me njëfarë pagese.

Rekomandime për veprime të mëtejme:

- ? të shtohen vizitat mjekësore në lokalitetet ku jetojnë komunitetet
- të përkrahen projektet e OJQ-ve dhe komuniteteve që kanë të bëjnë me shëndetin
- të përkrahen kategoritë e njerëzve me nevojë, kryesisht njerëz të moshuar që jetojnë të vetmuar
- të bëhet menaxhimi dhe bartja e mbeturinave nga fshatrat

- të shikohet mundësia e hapjes së një mini stacionari për shtirrjen e pacientëve në qendrën mjekësore të Gorazhdecit

2.6 Siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi

Përshkrimi i gjendjes:

Gati dhjetë vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë, komuniteti serb në komunën e Pejës jeton kryesisht në ato lokalitete ku paraqitet si shumicë. Kthimi është realizuar vetëm në disa fshatra, ku është kthyer një numër shumë i vogël banorësh, kurse në zonën urbane të Pejës ka një numër të kthyerve që poashtu është i vogël. Kthimi ka filluar në vitin 2003 në fshatin Bellopojë dhe atëherë është dashur të shoqërohet me masa sigurie, pasi 3-4 vjetëve të para pas lufte ishin shënuar disa incidente ndëretnike. Incidenti më i madh ishte ai i 17 marsit të vitit 2004 kur shtëpitë e sapondërtuara të fshatit Bellopojë ishin djegur nga protestuesit nga Peja. Megjithatë nga viti 2005 kur është realizuar kthimi në fshatrat Brestovik, Sigë e Lëvoshë asnjë incident ndëretnik nuk është shënuar.

Pjesëtarët e komunitetit serb tashmë lëvizin të lirë, dalin për punë administrative dhe shitblerje në Pejë të pashoqëruar nga policia e KFOR-i. As në hyrje të fshatrave më nuk ka nevojë për postblloqe. Në fshatin Gorazhdec ka një nënstacion të policisë së Kosovës, ku ka edhe të punësuar policë serbë, ndërsa baza me ushtarë italianë që ka ekzistuar në këtë fshat ka më se dy vjet që është larguar. Kjo atmosferë me e mirë dhe angazhimi i madh i autoriteteve komunale të Pejës dhe Qeverisë së Kosovës, kanë bërë që në dy vjetët e fundit të kemi edhe kthyerit e parë në qytetin e Pejës, që janë mirëpritur nga fqinjët e tyre, diçka që para disa vjetësh dukej e pamundur.

Por derisa në aspektin e kthimit, sigurisë dhe lirisë së lëvizjes së lirë janë bërë përparime të mëdha në këto pesë vjetët e fundit, në aspektin e përfaqësimit politik ka pasur kthim prapa. Serbët e Pejës nuk kanë asnjë përfaqësues në Kuvendin Komunal të Pejës. Në dy mandatet e para të Kuvendit Komunal nga viti 2001-2004 në kuvendin prej 41 anëtarësh ka pasur nga një përfaqësues të serbëve. Në dy palë zgjidhje lokale, subjektet politike serbe kanë marrë pjesë, por përfaqësuesit e tyre kanë qenë të emëruar nga përfaqësuesi i UNMIK-ut në marrëveshje me autoritetet komunale dhe me komunitetin. Në dy zgjedhjet e fundit komunale subjektet

politike serbe nuk kanë marrë pjesë në votimet komunale, dhe ata kanë mbetur pa përfaqësues në Kuvend. Llogaritet se kapacitetet votuese të tyre janë për të nxjerrë një ose dy deputetë komunalë. Angazhimi i autoriteteve komunale dhe kontakti me përfaqësuesit e komunitetit serb bashkë me përkrahjen nga autoritetet ndërkombëtare në Kosovë kanë krijuar një klimë shumë të mirë të komunikimit, që mund të shërbejë për të ndikuar tek komuniteti serb që të dalë në zgjedhjet lokale të planifikuara për vitin 2009.

Sa i përket trajtimit të komunitetit serb në komunën e Pejës qoftë në përfaqësim, në procesin e kthimit, integritimit dhe rindërtimit të shtëpive, gjithmonë autoritetet ndërkombëtare dhe pushteti lokal i Pejës kanë pasur parasysh se ky komunitet ka pasur një trajtim të veçantë krahasuar me komunitet tjera pakicë. Kjo ka ndodhur për shkak të procesit politik në Kosovë. Interesimi i faktorëve ndërkombëtar për komunitetin ka qenë i madh për shkak të luftës që ka ndodhur më parë dhe për shkak të garancive të vazhdueshme që është dashur të jepjen për serbët në Kosovë, për sigurinë e tyre, kthimin, integritimin, etj. Favorizimi i këtij komuniteti është bërë në procesin e kthimit, rindërtimit të shtëpive e punësimit, në krahasim me komunitet boshnjake, egjiptase e rome që aktualisht kanë numër më të madh të banorëve por kanë përfaqësim shumë më të vogël. Me të dhënat që ka UNHCR në Pejë ka rreth 1300 serbë dhe nga ta në komunë janë të punësuar 32, ndërsa nga komuniteti rom e egjiptian me 4169 pjesëtarë ka vetëm 15 të punësuar në komunë. Sa i përket ndërtimit të shtëpive të djegura gjatë luftës, serbët kanë përfituar rreth 200 shtëpi dhe është realizuar kthimi i organizuar në pesë lokalitete në komunën e Pejës, kurse për komunitetin rom e egjiptian është realizuar vetëm një projekt i kthimit të organizuar në lagjen "7 shtatori" ku janë ndërtuar 35 shtëpi. Për komunitetin boshnjak s'ka pasur asnjë projekt për kthim dhe numri i shtëpive që ata kanë përfituar nga donatorët është shumë më i vogël.

Iniciativat ekzistuese:

Gjuha serbe përdoret në shkollim, në shkollat e këtij komuniteti dhe mësohet me planprogramet e hartuara nga Ministria e Arsimit të Serbisë. Gjuha serbe është edhe gjuhë zyrtare në komunë. Në këtë gjuhë përkthehen të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentacioni komunal. Në këtë gjuhë janë edhe të gjitha mbishkrimet në institucionet shtetërore, shkolla, rrugë, tabela komunikacioni dhe çkado që shkruhet në ambientet publike.

Komuna e Pejës ka punësuar një numër pjesëtarësh të këtij komuniteti në tre sektorët e vet buxhetorë: në administratë, arsim e shëndetësi punojnë 32 pjesëtarë të këtij komuniteti. Edhe 8 tjerë punojnë në polici dhe 13 në shërbimet KEK, ujësjellës dhe PTK, që do të thotë gjithsej 53 të punësuar, që është një ndryshim pozitiv në krahasim me të kaluarën.

Në arsimin e lartë të Kosovës ka një mundësi për regjistrimin e studentëve të këtij komuniteti në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë ku zhvillohet mësimi në disa drejtime në gjuhën boshnjake.

Përfaqësimi i pakicave në parlamentin e Kosovës është i paraparë me Kushtetutën e Kosovës. Sipas kushtetutës në Parlamentin e Kosovës 100 vende deputeti fitohen me vota kurse 20 tjera janë të parapara për pakicat, nga të cilat 10 për serbët. Në Pejë një nënkryetar komune dhe një nënkryetar i Kuvendit komunal është i paraparë të jetë nga komunitetet pakicë. Momentalisht pasi që serbët nuk marrin pjesë në zgjedhje, këto vende i mbajnë një boshnjak dhe një egjiptian. Një përfaqësues i serbëve merr pjesë në Komitetin për politikë dhe financa, që është komiteti kryesor që krijon politikën komunale të Kuvendit, ndërsa të tjerë janë përfshirë në komitet tjera. Kuvendi ka dy komitete që janë të parapara për të trajtuar problemet e pakicave: Komitetin për komunitete dhe Komitetin për ndërmjetësim, në të cilat pakicat kanë shumicën e anëtarëve. Ndërsa në kuadër të qeverisë komunale ka dy zyra që merren me komunitetin: Zyra e komuniteteve dhe Zyra për kthim. Kuvendi Komunal ndan 11 përqind të buxhetit të tij vjetor për komunitetet pakicë. Komuna çdo vit harton strategjinë e kthimit dhe e miraton atë në Kuvend Komunal.

Rekomandime për veprime të mëtejme:

- të punohet në integritimin e komunitetit serb
- të punohet me komunitetin për të dalë në zgjedhjet e vitit tjetër
- të analizohet mundësia që të ketë vende të rezervuara për serbët në Kuvendin Komunal
- të nxiten projekte të përbashkëta multietnike që ndikojnë në kontakte ndërfaqjësore
- Të zhvillohen fushata vetdijësimi rreth funksionimit të institucioneve vendore, ligjet dhe rregulloret lokale

2.7 Kultura, mediat dhe informimi

Përshkrimi i gjendjes: Komuniteti serb në komunën e Pejës ka kulturën e vet dhe gjuhën të ndryshme nga komuniteti shumicë shqiptar që jeton në komunë. Për këtë arsye në çështjet e kulturës dhe informimit, komuniteti ka kërkesat e veta të veçanta dhe ato lidhen me lidhjen e pashkëputur që ka ky komunitet me vendin e vet amë-Serbinë. Kështu sa i përket informimit pothuaj tërësisht informohen nga mediat e Serbisë me qendër në Beograd. Në fshatin Gorazhdec ekziston një radio lokale që jep edhe informata lokale për komunitetin në komunën e Pejës dhe transmeton program 24 orësh. Radio Gorazhdec duke qenë pjesë e një rrjeti transmetues të radiove serbe në Kosovë, sjell edhe lajme të nevojshme nga komunat dhe lokalitetet tjera të komunitetit serb në Kosovë dhe deri diku ndikon në krijimin e një hapësire të përbashkët informimi dhe komunikimi mes vet komunitetit serb në Kosovë. Ndërsa sa i përket televizioneve, banorët e fshatit Gorazhdec janë të lidhur me një rrjet kabllovik, që u sjell atyre programet e televizioneve kryesore të Serbisë. Në fshatra kjo ndiqet me antena satelitore. Këto kanale ofrojnë programe të mjaftueshme informative, argëtuese e kulturore për komunitetin. Por komuniteti ka nevojë për më shumë lajme që kanë të bëjnë me jetën e serbëve në Kosovë dhe në komunën e Pejës, që janë të pakta në mediat qendrore të Serbisë. Komuniteti serb në Pejë nuk ka ndonjë medium të shkruar. Gazetat ditore dhe revistat një kohë të gjatë në Gorazhdec vinin nga Serbia, por këto dy-tri vjetët e fundit në fshat nuk arrin më shtypi serb. Për shtypin kosovar nuk ka ndonjë interesim. Për pesë vjet një pjesë e nevojës së komunitetit është plotësuar edhe me gazetën rajonale të shoqërisë civile "Kasneci" (Glasnik), gazetë e cila me financimin e OSBE-së, USAID dhe donatorëve tjerë deri në vitin 2007 kur është ndërprerë, është botuar në dy gjuhë shqip dhe serbisht dhe ka informuar për jetën dhe problemet e serbëve në tërë rajonin e Pejës. Gazeta është udhëhequr fillimisht nga OSBE e pastaj nga OJQ "Syri i Vizionit" nga Peja dhe në kuadër të saj ka pasur disa faqe kushtuar komunitetit serb.

Sa i përket kulturës, në komunën e Pejës ka disa objekte me rëndësi të trashëgimisë kulturore. Patrikana e Pejës është objekti kryesor dhe ai paraqet një nga pasuritë më të mëdha të trashëgimisë në komunën e Pejës. Ajo ka një mbrojtje dhe mbikëqyrje ndërkombëtare si një objekt i rëndësishëm i kultit për komunitetin serb si dhe një objekt me rëndësi të trashëgimisë në Kosovë.

Në kuadër të komunitetit momentalisht nuk ka asnjë shoqatë që do merrej me ruajtjen dhe vazhdimin e trashëgimisë kulturore folklorike serbe. Më parë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore popullore ka ekzistuar një shoqëri kulturore artistike, e cila ka më se dhjetë vjet që nuk funksionon. Deri më tani komuniteti nuk ka parashtruar kërkesën e krijimit të ndonjë farë SHKA apo qendre të kulturës serbe, që do të mund të luante rolin e një koordinatori të jetës kulturore. Ky organ mund të motivonte të rinjtë që të mësojnë dhe të mbajnë më tej këtë trashëgimi në të cilën përfshihen këngët, vallet dhe veshjet tradicionale serbe. Krijimi i këtij organi do duhet të përkrahej edhe me faktin se duhen fonde duke filluar që nga veshjet tradicionale që janë shumë të shtrenjta, etj. Përderisa në fshatin Grazhdec ka një infrastrukturë dhe hapësirë të duhur, fshatrat tjera kanë kërkesa për ndërtimin e objekteve të vogla që do luanin rolin e mini shtëpive të kulturës. Në fshatin Bellopojë ka një qendër kulture por është e pa pajisur. Këto shtëpi kulture në fshatra do ishin në shërbim qoftë për aktivitete kulturore, të rinisë, gruas dhe për nevojat e komunitetit.

Iniciativat ekzistuese:

Ne televizionin publik të Kosovës RTK ka lajmet 15 minutash çdo ditë në gjuhën serbe, ndërsa në mbrëmje gjysmë ore përcjellë lajmet e Zërit të Amerikës në gjuhën serbe. Ky televizion poashtu ka një magazinë javore një orë në gjuhën serbe "Nedeljni kolaz". Këto emisione shërbejnë sadopak në informimin në gjuhën dhe kulturën serbe. Programi në gjuhën serbe poashtu jep edhe informata për jetën e komunitetit dhe zhvillimet që ndodhin në këtë komunitet, ngjarjet me rëndësi dhe zhvillimet duke krijuar një hapësirë lidhje mes serbëve të Kosovës.

Radio Gorazhdec është një radio në të cilin shumë organizata kanë dhënë donacione dhe janë zhvilluar shumë projekte në mënyrë që të ketë një radio lokale vërtetë në shërbim të komunitetit.

Gazeta "Kasneci" për pesë vjet ka sjellë zhvillimet nga komunat e rajonit në botimin në gjuhën serbe dhe ka sjellë për lexuesin shqiptar problemet që ka komunitetit serb në komunat Pejë, Klinë, Deçan e Istog.

Rekomandime për veprime të mëtejme:

- të përkrahet krijimi i një SHKA-je (ose ndonjë organi tjetër kulturor) që do merrej me ruajtjen e trashëgimisë folklorike të

- komunitetit serb
- ta ndahet buxhet për ruajtjen e trashëgimisë së këtij komuniteti
- të financohet ndërtimi i shtëpive të kulturës nëpër fshatra
- të shikohet mundësia e hapjes së një gazete në gjuhën serbe ose të vazhdohet botimi i gazetës *Kasneci/Glasnik*
- të promovohen programe për ruajtjen e trashëgimisë kulturore serbe në komunën e Pejës

2.8 Të drejtat e femrave

Përshkrimi i gjendjes: Sa i përket pozitës së femrës në komunitetin serb, nuk ka ndonjë dallim me komunitetet tjera në këtë komunë. Familjet e këtij komuniteti kryesisht janë familje patriarkale që funksionojnë në mënyrë të tillë që nuk i japin shumë hapësirë pjesëmarrjes së gruas në jetën politike e shoqërore të komunitetit. Subjektet politike të komunitetit serb nuk kanë organizatat e gruas në kuadër të partisë, ndërsa edhe interesimi i grave për politikën nuk është shumë i madh. Sa i përket punësimit dallimi mes mashkullit e femrës nuk është i madh në sektorin publik, porse në familjet e shumta të papuna gratë kryesisht merren më punët e shtëpisë dhe amvisëri.

Në këto dhjetë vjet ka pasur përpjekje për të krijuar një sektor joqeveritar të organizimit të grave. OJQ "Briga" nga fshati Gorazhdec mbledh në aktivitete e veta edhe gra nga lokalitetet serbe, ndërsa më parë ka ekzistuar edhe një OJQ tjetër me emrin "Gorazhdanke". Ato kanë zhvilluar disa projekte me përkrahjen e donatorëve dhe kanë kyçur në projekte një numër të grave të komunitetit.

Në fshatrat tjera ka një numër të vogël të grave dhe nuk ka mundësi për organizim të grave apo për përpjekje të organizuar për të bërë diçka në emër të femrave brenda komunitetit. Në fshatin Lëvoshë komuniteti ka paraqitur kërkesën për një ambient në të cilin do të mund të mblidheshin gratë, dhe ku mund të përpunonin dhe realizonin projekte që lidhen me aktivitetin dhe nevojat e tyre.

Iniciativat ekzistuese:

Në fshatin Gorazhdec ka një organizim të femrave në organizatën joqeveritare "Briga", organizatë kjo që mbledh gratë e fshatit, por edhe që zhvillon aktivitete edhe në fshatrat tjera. Ndër projektet e kësaj organizate ka qenë edhe ai i aftësisimit të 30 grave në

profesione, rrobaqepësi, etj. "Briga" ka edhe lokalit e saj në të cilin ka pajisjet e makineritë për një mini fabrikë qepëse në të cilën do të mund të punësoheshin një numër i grave. Si pjesë e projekteve që janë zhvilluar në komunitet gjatë vjetëve të kaluara në Gorazhdec ka edhe një sallon frizerësh me pajisje fillestare për punë dhe një ëmbëltore, që poashtu do të mund të punësonte edhe një numër të grave të këtij komuniteti.

Rekomandime për veprime të mëtejme:

- të krijohet sa më shumë hapësirë për përfshirjen e femrës së komunitetit serb në aktivitetet politike e shoqërore
- ta organizohen kurse për femrat, kurse për kompjuterët, internetin etj, por edhe kurse të aftësisimit në profesione të ndryshme
- të krijohet mundësi punësimi për femrat
- të përkrahen idetë e organizatave të grave dhe që kanë të bëjnë me femrat
- të vihen në punë kapacitetet që ekzistojnë në fshatin Gorazhdec ku do punësohej një numër femrash



III. Ndërhyrja në komunitet

3.1 Hyrje

Kjo pjesë e kësaj strategjie ka të bëjë me qasja nëpër lokalitete të ndryshme, me projekte të veçanta nëpër lagje dhe fshatra të komunës së Pejës. Kryesisht më të shpeshta në këtë pjesë janë projektet për infrastrukturën, projektet e infrastrukturës, bujqësinë, zhvillimin ekonomik, etj. Në këtë pjesë gjatë hartimit të strategjisë bashkë me komunitetin SiV ka tentuar të bëjë edhe përlllogaritjen e përafërt të kostos së implikimit buxhetor për projektet e veçanta.

Në këtë mënyrë këto kërkesa të komunitetit kanë marrë formën e mini projekteve, në të cilat sipas një modeli të përbashkët janë përcaktuar disa kërkesa si kostoja e përafërt e llogaritur e çmimit, objektivat dhe qëllimet, përfituesit, etj. Këto të dhëna janë konsideruar si pasqyrë e parë për t'u paraqitur para komunës dhe donatorëve për të matur mundësinë e angazhimit financiar.

Zbatimi i këtyre projekteve zbut problemet më të dukshme të komunitetit që bien në sy në shikim të parë në vendet ku jeton, por nuk i zgjodh në përgjithësi problematikat lidhur me komunitetin, prandaj kjo pjesë e tretë e kësaj strategjie duhet parë si shtojcë e pjesës së dytë në të cilin jepen rekomandimet.

Në këtë listë projektesh janë përfshirë shtatë lokalitetet kryesore, ato fshatra ku kërkesat e komunitetit mund të artikulojnë dhe të shprehen para donatorëve.

3.2 Fshati Bellopojë

Bellopoja shtrihet në jug-perëndim të qytetit të Pejës dhe gjendet mes lagjeve Zatra në veri, në lindje Karagaqi dhe Dardania, në jug i ka fshatrat si Loxha dhe Raushiqi, ndërsa në perëndim kufizohet me Lubeniçin dhe Zagërmen. Këtu para luftës por edhe tash jeton kryesisht komuniteti serb, kishte disa familje të komunitetit shqiptar dhe atij egjiptian të cilat janë edhe sot. Bellopoja para luftës së fundit ishte fshat pothuajse urban me rreth 1200 banorë me rreth 300 shtëpi, ndërsa tani janë ndërtuar 71 shtëpi dhe aty momentalisht jetojnë rreth 60 persona kryesisht kryefamiljarë dhe të moshuar. Sipas infrastrukturës Bellopoja i ka gjitha tiparet që të jetë një lagje si me afërsi dhe ndërlidhje me qytetin po ashtu edhe me infrastrukturën e banimit, atë rrugore, furnizimin me ujë, rrymë, kanalizimin për ujërat meteorologjike si dhe infrastrukturën tjetër që ekziston në fshat. Njerëzit tani jetojnë nga të ardhurat sociale dhe pensionale si dhe nga bujqësia, sepse edhe pse janë tepër pak në numër, i punojnë tokat e tyre si dhe e kanë organizuar jetën aty. Njerëzit qarkullojnë sa aty, sa në Serbi por në shumicën e shtëpive të ndërtuar ka së paku nga një anëtar të familjes.

Titulli i Projektit: Restaurimi i objektit shkollor

Sektori: Arsim

Kohëzgjatja: 1 vit (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Bellopojë - Pejë

Buxheti: 100.000 €

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për synim krijimin e kushteve për shkollimin e të rinjve të fshatit Bellopojë në klasat fillestare nga e para e deri në të katërtën.

Objektivat:

- Ndërtimi i objektit për arsimim në gjuhën amtare nga klasa e parë e deri në të katërtën të shkollës fillore
- Krijimi i kushteve për kthim të komunitetit serb në fshatin Bellopojë edhe në formë spontane
- Ndryshimi i opinionit të komunitetit rreth kushteve dhe jetës në Kosovë
- Integrimi i komunitetit serb në shoqërinë kosovare
- Zbutja e papunësisë përmes punësimit të disa pjesëtarëve të komunitetit si mësimdhënës

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë të gjithë banorët e fshatit Bellopojë të cilëve do t'u ofrohen kushte më të mira për arsimim dhe kthim të qëndrueshëm. Përfitues të veçantë të këtij projekti janë fëmijët dhe të rinjtë të cilët do të kenë mundësinë e vijimit të shkollës brenda fshatit pa udhëtuar drejt ndonjë fshati tjetër apo edhe vendi tjetër.

Qasja:

Në fshat ekziston shkolla e djegur dhe dëmtuar e cila do rinovohej. Aty hyn vendosja e çatisë së re, renovimi i mureve dhe hapësirave të brendshme, nyjës sanitare dhe pajisja me pajisje elementare për funksionim.

Titulli i Projektit: Vizitat mjekësore për banorët e fshatit Bello Pojë

Sektori: Shëndetësi

Kohëzgjatja: 3 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Bellopojë - Pejë

Buxheti: 8.000 €

Qëllimi i projektit:

Organizimi i vizitave nga mjekët specialistë tek banorët e fshatit Bellopojë në veçanti për personat e shtyrë në moshë dhe ata të cilët nuk kanë përkujdesje familjare.

Objektivat:

- Ngritja kualitetit të ofrimit shërbimeve mjekësore
- Përkujdesja adekuate për të moshuarit dhe ata që janë pa përkujdesje familjare
- Krijimi i kushteve më të mira si dhe integrimi më i mirë i komunitetit serb në shoqëri
- Ngritja e nivelit të sigurimit shëndetësor në vendet rurale për të gjithë

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë të gjithë banorët e fshatit Bellopojë, komuniteti i fshatit Bellopojë me theks të veçantë personat të cilat janë të shtyrë në moshë dhe nuk kanë përkujdesje të nevojshme familjare dhe jetojnë të vetëm në familje.

Qasja:

Mjekët e mjekësisë familjare do bënin vizita mjekësore në fshat një herë në javë për të gjithë banorët e fshatit. Edhe vizita e mjekëve specialistë do ishte e preferuar

Titulli i Projektit: Ndriçimi i kishës ortodokse në Bellopojë

Sektori: Kulturë

Kohëzgjatja: 1 vit (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Bellopojë - Pejë

Buxheti: 5.000 €

Qëllimi i projektit:

Ruajtja e vlerave kulturore fetare përmes ndriçimit të kishës ortodokse në fshatin Bellopojë, e cila është në kushte të mira infrastrukturore, në mungesë të ndriçimit është thuajse a pa shfrytëzueshme.

Objektivat:

- Ruajtja e vlerave kulturore dhe fetare për komunitetin serb
- Funksionimi i kishës dhe vënia në funksion e saj për t'i shërbyer komunitetit të fshatit
- Shtimi i mirëbesimit në institucionet legale përmes kësaj përkrahjeje të nevojitur
- Avancimi i kujdesit ndaj objekteve kulturore të këtij vendi

Përfituesit:

Me këtë investim përfiton komuniteti ortodoks-serb në kuptimin e ngritjes së sigurisë gjenerale si dhe me atraktivitet që do t'i shtohet fshatit. Po ashtu edhe vet qyteti përfiton me dukshmërinë e këtij objekti kulturor, i cili me këtë rregullim mund të nxitë vizita të turistëve të ndryshme në këtë vend e që është në përfitim të tërë shoqërisë.

Qasja:

Me projekt bëhet ndriçimi i pjesës së jashtë të kishës, oborrit brenda rrethojave me vendosjen e ndriçuesve në katër skajet e oborrit dhe krijimin e një zone të ndriçuar përrreth kishës.

Titulli i Projektit: Telefonia fikse në Bellopoj
Sektori: Komunikim
Kohëzgjatja: 1 vit (duke filluar nga viti 2009)
Vendi: Bellopojë- Pejë
Buxheti: 10.000 €
Qëllimi i projektit:

Hapja e rrjeti të telefonisë fikse në fshatin Bellopjë. Me futjen e telefonave fikse në fshat përmirësohet kualiteti e jetesës, krijohen lidhje e komunikim me familjet dhe mundësohen lidhjet me internetin shërbime tjera. Furnizimi i komunitetit me këto shërbime ofron integrim miq të mirë në shoqëri si dhe një të drejtë e gëzojnë të gjithë.

Objektivat:

- Pajisja e komunitetit me shërbime të nevojshme të telekomunikacionit
- Përmirësimi i lidhjes telefonike dhe pajisja me shërbime shtesë më të sofistikuar
- Shtimi i infrastrukturës urbane në fshat si dhe punësimi i të kthyerve në këto institucione
- Avancimi i komunikacionit jo vetëm brenda komunitetit por edhe zgjerimit të rrjetit komunikues në favor ekonomik

Përfituesit:

Përfituesit direkt do të janë banorët e këtij fshati të cilëve do të iu përmirësohet aspekti komunikimit si dhe oferta tjera si interneti e beneficione tjera.

Qasja:

Rrjeti i fshatit do lidhej me telefoninë ekzistuese në qytetin e Pejës. Zgjatja e rrjetit do bëhej për jo më shumë se 500 metra deri në brendi të fshatit.

Titulli i Projektit: Restaurimi i rezervuarit të ujit të pijshëm
Sektori: Infrastrukturë
Kohëzgjatja: 2 vite (duke filluar nga viti 2009)
Vendi: Bellopojë - Pejë
Buxheti: 30.000 €
Qëllimi i projektit:

Ndërtimi i rezervuarit për ujë të pijshëm të burimi natyral që gjendet mbi fshat e që gjysmën e fshatit e furnizon, sepse është më i lart se niveli i ujit të kompanisë publike "ujësjellësi" që e furnizon fshatin me ujë të pijshëm. Me këtë projekt zgjidhet mungesa e ujit gjatë verës në fshat posaçërisht gjatë ditëve tejet të nxehta të verës.

Objektivat:

- Eliminohen reduktimet e ujit të pijshëm në fshat duke u shndërruar jeta e përditshme në një gjendje më të kënaqshme
- Përmirësohet furnizimi i ujit të pijshëm dhe krijohen kushtet më të mira për kthim të qëndrueshëm dhe jetës në Bellopojë
- Ngritet mirëbesimi i komunitetit serb të këtij fshati në institucionet lokale si dhe qasja ndaj tyre
- Përmirësohet gjendja aktuale në aspektin shëndetësor, ambientor, bujqësor e social

Përfituesit:

Me këtë projekt së pari përfitojnë banorët e lagjes duke u pajisur në formë të drejt dhe të duhur me ujë të pijshëm, po ashtu eliminohet edhe mundësia e paraqitjes së sëmundjeve të ndryshme e posaçërisht atyre epidemike që nuk mund të lokalizohen shpejt. Përmirësohet çështja ambientale dhe bujqësore që pozitivisht reflektohet në ekonomi, mirëqenie sociale dhe shumë aspekte të tjera të ndërlidhura.

Qasja

Do riparohej rezervoari ekzistues i ujit në tokat nga malet sipër fshatit. Rezervoari do zgjerohej dhe riparohej për të shtuar kapacitetin dhe për të përfshirë më shumë banorë të këtij fshati.

Titulli i Projektit: Pajisja dhe funksionimi i shtëpisë së Kulturës në Bellopojë

Sektori: Kulturë

Kohëzgjatja: 2 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Bellopojë - Pejë

Buxheti: 30.000 €

Qëllimi i projektit:

Krijimi i kushteve më të mira për jetë në këtë fshatë, me vënien në funksion të shtëpisë së kulturës në fshatin Bellopojë, ku njëherit do të krijonte kushte më të mira edhe për kthimin e të rinjve në këtë fshat duke iu ofruar kushte dhe atraktivitetet për kthim të qëndrueshëm.

Objektivat:

- Funksionimi i shtëpisë së kulturës në fshat dhe aktivizimi i të rinjve, grave dhe të moshuarve në fusha ekonomike dhe shoqërore
- Organizimi i aktiviteteve kulturore, sportive dhe argëtuese mes të rinjve me përkatësi etnike të ndryshme duke mundësuar kthim të qëndrueshëm për të rinjtë
- Avancohet jeta në disa sfera që rezulton me përmirësim të jetës në përgjithësi

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti do të jenë banorët e fshatit, por edhe ata të cilët do të kthehen në të ardhmen. Njëkohësisht përfitues më direkt do të jenë të rinjtë e komunitetit serb. Me pajisjen e shtëpisë së kulturës do të përmirësohet edhe gjendja aktuale e sigurisë, integritetit, bashkëpunimit dhe mirëbesimit të ndërsjellë.

Qasja

Sipas këtij projekti do të pajiset shtëpia e kulturës me pajisje adekuate si kompjuter dhe inventar shtesë, tavolina, karrige dhe shumë pajisje tjera të cilat do mundësonin funksionimin e këtij objekti në formën më të mirë të mundshme dhe do ta bënë atë më të shfrytëzueshëm për të organizuar aktivitete të ndryshme kulturore, edukative apo aktivitete tjera.

Titulli i Projektit: Ndërtimi i fushës për futboll të vogël

Kohëzgjatja: 1 vit (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Bellopojë - Pejë

Buxheti: 12.000 €

Qëllimi i projektit:

Ndërtimi i një terreni për zhvillimin e lojërave të futbollit të vogël, i cili do të i stimulojë të rinjtë të qëndrojnë në fshat dhe të organizojnë jetën dhe të ardhmen e tyre. Kjo njëkohësisht do ta nxisë edhe kthimin e qëndrueshëm nga ky komunitet në këtë fshat.

Objektivat:

- ? Ndërtimi i një terreni për futboll të vogël të rinjve nga ky fshat
- Krijimi i kushteve më të përshtatshme për kthimin e të rinjve
- Krijimi i kushteve për organizimin e jetës normale për të rinjtë

Përfituesit:

Me këtë projekt përfitojnë të rinjtë nga ky fshat sepse krijohen mundësitë elementare për organizim të jetës normale për të rinjtë. Po ashtu përfiton edhe i tërë komuniteti, sepse nxitet kthimi edhe i të rinjve.

Qasja:

Ndërtimi i një terreni të dimensioneve 23x42 metra në hapësirë të oborrit të shkollës dhe pranë Pallatit të Kulturës në këtë fshat. Këtu nevojitet të bëhet rrafshimi i terrenit, asfaltimi i tij dhe ndërtimi i rrethojës si dhe pajisja me mjete përcjellëse për zhvillim të lojërave në fjalë.

3.3 Fshati Sigë

Fshati Sigë gjendet në pjesën veriore të komunës së Pejës dhe shtrihet nga lagja Llazoviq e qytetit të Pejës në jug e deri të Radavci.

Siga është fshat që kryesisht shtrihet në pjesën e epërme të rrugës Pejë-Rozhajë, e cila edhe e ndan me Vitomicën. Ky fshat ishte tërësisht i shkatërruar në luftën e fundit dhe është përplot me mbeturina jo vetëm të këtij fshati por edhe nga mbeturinat e djegies së shtëpive në qytet, të cilat janë deponuar në këtë fshat pa kurrfarë leje dhe organizimi. Fshati dikur kishte rreth 170 banorë nga komunitetet serb dhe egjiptian me mbi 300 hektarë tokë që është punuar, kurse tani aty janë ndërtuar 34 shtëpi për serbët e kthyer dhe rreth 15 egjiptianë, që tërësisht shfrytëzojnë vetëm 10% të tokës pjellore. Në këtë fshat ka mjaft tokë të mirë pjellore, e cila në kushte normale do të mundësonte komunitetit që të kenë të ardhura të mira financiare, mirëpo tani banorët nuk kanë mundësi të punimit të tokës për shkak të mungesës së mjeteve për përpunimin e tokës si dhe pamundësia nga mbeturinat të cilat janë të grumbulluara sidomos në tokat pjellore.

Titulli i Projektit: Pastrimi i mbeturinave dhe vendosja e kontejnerëve në fshat

Sektori: Ambienti

Kohëzgjatja: 6 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Sigë - Pejë

Buxheti: 5.000 €

Qëllimi i projektit:

Projekt ka për synim të krijojë një ambient më të pastër në fshat, të mbrojë shëndetin e banorëve të këtij fshati, si dhe të vetëdijesojë banorët në mirëmbajtjen e ambientit në vendin ku jetojnë. Njëherit bëhet edhe mbrojtja e tokave pjellore dhe shtëpive.

Objektivat:

- Vendosja e kontejnerëve për mbeturina
- Krijimi i një shoqërie më të shëndoshë dhe më të pastër përmes ruajtjes së ambientit dhe pastërtisë
- Pastrimi i deponive ilegale të mbeturinave
- Ofrimi i shërbimeve më të mira për mirëmbajtje të ambientit

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë banorët e fshatit Sigë, të gjitha komunitetet. Me vendosjen e kontejnerëve në fshat do të rritet niveli i pastërtisë në fshat. Kushte më të mira për të jetuar aty e në veçanti shëndet më të sigurt, pas vendosjes së kontejnerëve dhe largimit të mbeturinave nga tokat pjellore, shtëpitë e rrënuara të fshatit dhe deponive ilegale.

Qasja:

Sipas këtij projekti do të vendosen 5 kontejnerë në fshat, do të pastrohen vendet ilegale, tokat dhe shtëpitë nga mbeturinat që janë krijuar nga vetë banorë e fshatit. Do të angazhohet kompania për shërbime publike që t'u ofrojë shërbim çdo javor për pastrimin e kontejnerëve dhe largimin e mbeturinave.

Titulli i Projektit: Fuqizimi i grave përmes kurseve

Spektori: Barazia gjinore

Kohëzgjatja: 1 vit (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Sigë - Pejë

Buxheti: 10.000 €

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim që t'u mundësojë grave të komunitetit që të aktivizohen në përmirësimin e kushteve të jetesës për to dhe familjet e tyre në aspektin e punësimit.

Objektivat:

- Zbutja e papunësisë në komunitet
- Rritja e aktiviteteve të grave si dhe aktivizimi i tyre në shoqëri
- Angazhimi i femrës me qëllim zbutjen e gjendjes ekonomike por edhe ngritja e bashkëpunimit ndëretnik përmes tregtisë
- Sigurimi i kthimit të qëndrueshëm
- Anulimi i anashkalimit të vazhdueshëm të gruas në vendimmarrje

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë gratë e komunitetit të kthyer duke u angazhuar në jetën publike si dhe në aspektin ekonomik duke e ngritur buxhetin familjar si dhe sigurinë ekonomike. Përfiton komuniteti i kthyer sepse me aftësim dhe angazhim e kësaj pjese të komunitetit shumëfish përmirësohet pozitivisht gjendja aktuale në komunitet por edhe në rajon.

Qasja:

Do të realizohen kurse dhe aktivitete të ndryshme mbi rrobaqepësinë dhe punë dore ku më pas gratë e komunitetit do të kenë mundësinë e vazhimit të punës personale duke kryer shumë shërbime të ndryshme sa i përket punë dorës ku përfshihen rrobaqepësia, qëndisja dhe të tjera. Aty do përfshiheshin edhe kurset për frizerë etj, në mënyrë që të ketë një larmi të mundësive për këto femra.

Titulli i Projektit: Furnizimi i fshatit me serë për perimet

Spektori: Bujqësi

Kohëzgjatja: 1 vit (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Sigë - Pejë

Buxheti: 10.000 €

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për synim do të nxisë perspektivën e fshatit në prodhimtarin e fidanëve për perime, për çka i ka gjitha kushtet të jete e suksesshme. Me këtë projekt avancohet sektori bujqësisë në komunë dhe shfrytëzohen në formë më adekuate toka pjellore, si dhe mundësit janë që këto produkte edhe të eksportohen edhe jashtë vendit e veçanërisht në Mal të Zi.

Objektivat:

- Punësimi i të kthyerve si dhe sigurimi i kthimit të qëndrueshëm
- Avancimi i sektorit bujqësor të rajonit të Pejës dhe më gjerë
- Përmirësimi i kushteve ekonomike në pjesët rurale përmes prodhimtarisë natyrale dhe të shëndoshë
- Promovimi i produktit vendor edhe jashtë kufijve të vendit
- Prodhimi dhe plasim në treg i perimeve të freskëta në çdo stinë dhe me çmime më të ulëta

Përfituesit:

Përfitues janë të gjithë banorët e fshatit dhe në veçanti komuniteti i kthyer serb, i cili do të jetë vetë i angazhuar në prodhimtari dhe në plasim në tregun vendor por edhe të jashtëm, po ashtu edhe qytetarë të tjerë përfitojnë sepse u ofrohen prodhimet e freskëta, natyrale dhe të shëndosha në çdo kohë dhe me çmim shumë të pranueshëm duke u përshtatur kushteve aktuale ekonomike në vend.

Qasja:

Projekti parasheh ndërtimin e një sere në fshat dhe organizimin e komunitetit për të udhëhequr projektin e zhvillimit bujqësor. Sera do menaxhohej nga grupimi i afërmerëve dhe përfshinte tokat e tyre bujqësore.

Titulli i Projektit: Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës në fshatin Sigë

Sektori: Kulturë

Kohëzgjatja: 1 vit (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Sigë - Pejë

Buxheti: 50.000 €

Qëllimi i projektit:

Ndërtimi i këtij objekti që do të shërbejë për pasurimin e aktiviteteve të përditshme kulturore, po ashtu edhe për takime të komunitetit në aktivitete të përbashkëta si dhe normalizimin e jetës së përditshme për banorët e në veçanti për të rinjtë.

Objektivat:

- Ngritja e nivelit të aktiviteteve kulturore e argëtuese në Sigë
- Ndërtimi i shtëpisë të kulturës për komunitetin e kthyer
- Ngritja e bashkëpunimit dhe besimit të ndërsjellët mes institucioneve dhe komunitetit të kthyer të fshatit Sigë
- Përkrahja e komuniteteve minoritare në aspektin kulturor
- Krijimi i kushteve për bashkëpunim me komunitetet tjera në aspektin kulturor dhe argëtues
- Krijimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm për të rinjtë nga komuniteti serb

Përfituesit:

Me ndërtimin e Pallatit të Kulturës në Sigë përfitues direkt do të jenë banorët e fshatit Sigë kryesisht komuniteti serb, duke mos anashkaluar edhe komunitetet e tjera, sepse krijohet edhe një mundësi për bashkëpunim mes të rinjve të komuniteteve të ndryshme.

Qasja:

Do ndërtohej një objekt kulturës për nevojat e komunitetit. Eksiton edhe mundësia e përshtatjes së ndonjë objekti ekzistues. Objekti i ri do ishte ndërtesë njëkatëshe me 150 metra katrore me hapësirat për aktivitete, mbledhje dhe nevojat e komunitetit.

3.4 Fshati Gorazhdec

Fshati Gorazhdec gjendet 7 kilometra larg qytetit të Pejës. Fshati Gorazhdec është ndër fshatrat më të mëdha në komunën e Pejës dhe në pjesën më të madhe banohet nga pjesëtarët e komunitetit serb. Banorët serbë në këtë lokalitet nuk janë zhvendosur fare. Fshati ka një numër të madhe të banorëve duke përfshirë këtu edhe të rinjtë që janë në një numër të konsiderueshëm që jetojnë në këtë fshat. Gorazhdeci ka shkollën fillore dhe atë të mesme me disa drejtime, me mësimdhënës të komunitetit serbë dhe kryesisht fëmijët që vijojnë në këto shkolla janë të komunitetit serb. Po ashtu në Gorazhdec ekziston edhe zyra ndërlidhëse e pushtetit Lokal, ka një nënstacion policor të Policisë së Kosovës me rreth 15 policë, ambulancën e mjekësisë familjare me specializim të ndryshëm dhe me rreth 20 të punësuar. Po ashtu fshati Gorazhdec ka edhe Shtëpinë e Kulturës ku në brendësi të tij gjendet edhe radio lokale Radio Gorazhdeci. Gjithashtu në fshatin Gorazhdec për dallim nga vendet e tjera jeta kulturore dhe rinore është më e zhvilluar, ekzistojnë edhe qendra rinore po ashtu edhe qendrat e grave të cilat merren me aktivitete të ndryshme të jetës së grave si punë dore dhe aktivitete të tjera që mundëson aktivizimin e grave në këtë pjesë.

Titulli i Projektit: Projekti i emancipimit të grave

Sektori: Barazi gjinore

Kohëzgjatja: 2 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Gorazhdec - Pejë

Buxheti: 4.000 €

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për synim emancipimin e grave përmes trajnimeve, edukimit dhe formave tjera për të ngritur nivelin e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje dhe angazhimin më të madh në jetën publike. Vetë angazhimi i grave krijon mundësinë për ndryshime shoqërore

Objektivat:

- Vetëdijesimi i grave mbi rolin dhe rëndësinë e gruas në shoqëri aktuale.
- Fuqizimi i gruas për vetiniciativa të ndryshme.
- Krijimi i parakushteve për zhvillimin e emancipimit në vend.
- Përkrahja adekuatë e gruas për pjesëmarrje në vendimmarrje.
- Gruaja të jetë bartës i ideve të ndryshme dhe faktor relevant në jetën publike shoqërore të vendit.

Përfituesi:

Përfitues të këtij projekti janë gratë e komunitetit serb në fshatin Gorazhdec po ashtu dhe shoqëria e gjere. Po ashtu ky projekt është shpresë dhënës dhe mund të jetë i frytshëm për nxitjen e projekteve tjera bashkëpunimit ndëretnik në gjitha sferat të jetës publike me interes të përbashkët.

Qasja:

Disa trajnime do mbahen me gratë dhe vajzat e fshatit Gorazhdec në mënyrë që ato të angazhohen në jetën e shoqërisë. Në këto trajnime do aftësohen në profesione dhe shkathtësi të ndryshme përmes kurseve të ndryshme të mbajtura për femrat që do forcojnë pozitën e tyre.

Titulli i Projektit: Restaurimi i Shtëpisë së Kulturës

Sektori: Kulturë

Kohëzgjatja: 2 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Gorazhdec - Pejë

Buxheti: 10.000 €

Qëllimi i projektit:

Përmirësimi i imazhit të vendit si dhe mundësinë e shfrytëzimit për aktivitete e ndryshme për të mirën e të rinjve, njëherit duke fuqizuar edhe komunitetin në përgjithësi.

Objektivat:

- Organizimi i aktiviteteve kulturore
- Stimulimi i të rinjve për t'u marr me aktivitete artistike, hapja e ekspozitave
- Aktivizimi i të rinjve në fshat përmes organizimeve të ndryshme
- Rregullimi i infrastrukturës dhe ambientit në qendër të fshatit

Përfituesi:

Përfitues të këtij projekti janë të gjithë banorët e fshatit Gorazhdec, të cilët do të kenë mundësinë e vënies në funksion të Pallatit të kulturës, njëherit edhe aktivizimit të jetës në këtë fshat. Përfitues më direkt në këtë projekt do të jenë të rinjtë, që do të kenë mundësinë e organizimit të aktiviteteve të ndryshme, të cilat do të ndihmonin që të rinjtë të kenë një jetë më të pasur kulturore dhe artistike.

Qasja:

Do të bëhet renovimi i Shtëpisë të kulturës. Objekti ekzistues në qendër të fshatit është në gjendje të përdorimit, por ai ka nevojë për riparime pasi që një kohë të gjatë ai është dëmtuar. Hapësirat e brendshme të tij kanë nevojë për riparime, nyjat e reja sanitare dhe muret e brendshme të objektit.

Titulli i Projektit: Ndërtimi i një terreni për futboll të vogël

Spektori: Rini

Kohëzgjatja: 9 Muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Gorazhdec - Pejë

Buxheti: 15.000 €

Qëllimi i projektit:

Ndërtimi i fushës së futbollit të vogël për të rinjtë e komunitetit në fshatit Gorazhdec. Ku të rinjtë do të kenë mundësinë e realizimit të aktiviteteve sportive për gjatë gjithë kohës.

Objektivat:

- Aktivizimi i të rinjve në sportet e ndryshme.
- Largimi i të rinjve nga dukuritë negative dhe pasurimi i jetës së tyre me aktivitete kreative
- Fuqizimi i të rinjve në kërkim të ideve dhe mundësive për angazhim pozitiv dhe pasurim të aktiviteteve.
- Kushte më të mira për të rinjtë që merren më futboll

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë të rinjtë e komunitetit serb, po ashtu përfitues të tjerë janë edhe nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme të fshatit pasi që mund të zhvillojnë aktivitete sportive në këtë fushë.

Qasja:

Sipas këtij projekti do të ndërtohet fusha e sportit e cila duhet të jetë e mbuluar për shkaqe të kohës dhe stinëve të ndryshme. Po ashtu me realizimin e këtij projekti të rinjtë kanë mundësinë edhe të organizimit të turnirëve të ndryshme në futboll dhe sporte të tjera.

Titulli i Projektit: Fuqizimi i qendrës së gruas për vet qëndrueshmëri

Spektori: Barazi gjinore

Kohëzgjatja: 2 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Gorazhdec - Pejë

Buxheti: 5.000 €

Qëllimi i projektit:

Furnizimi me pajisje për rrobaqepësi, floktari dhe mjete tjera për të siguruar një qëndrueshmëri të kësaj qendre që kultivon artizanatet tradicionale. Organizimi i aktiviteteve të ndryshme për të ndihmuar gratë e vjetra që jetojnë të vetmuara dhe pa përkujdesje të familjareve apo institucioneve përkatëse.

Objektivat:

- Furnizimi qendrës së gruas me material për makina qepëse
- Furnizimi i qendrës me mjete për kurset e floktarisë për femra
- Aftësimi i grave në aspektet e ndryshme për vet qëndrueshmëri
- Krijimi i kushteve më të mira për gratë e moshuara
- Përkrahja institucionale, kujdesi ndaj grave të vjetra dhe atyre që nuk kanë përkujdesje familjare

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë kryesisht gratë, ato të shtyra në moshë që nuk kanë përkrahje nga askush dhe nuk kanë kurrfarë të ardhura financiare. Po ashtu përfitues mund të jenë të gjitha gratë dhe vajzat të cilat shprehin interesim të vetëdijesimit mbi kurset e ndryshme që në të ardhmen mund t'iu krijojnë kushte më të mira financiare.

Qasja:

Qendra e gruas në fshatin Gorazhdec do përkrahej me materiale dhe mjete të punës në mënyrë që qendra të aktivizojë kapacitetet e saj ekzistuese që mundësojnë punësimin dhe angazhimin jo vetëm të femrave të komunitetit por edhe nga rrethina.

Titulli i Projektit: Rregullimi i shtratit të lumit dhe kanalit ujitës

Sektori: Bujqësi

Kohëzgjatja: 3 Muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Gorazhdec - Pejë

Buxheti: 10.000 €

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për synim rregullimin e shtratit të lumit si dhe mundësimin e kanaleve të ujitjes për zhvillimin e bujqësisë në fshat.

Objektivat:

- Pastrimi dhe riparimi i kanalit për ujitjen e tokës bujqësore
- Rregullimi infrastrukturor për banorët e fshatit Gorazhdec
- Zgjerimi i kanalit ekzistues dhe shtimi i sasisë së ujit që rrjedh
- Përmirësimi i kushteve për bujqësi

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti do të jenë të gjithë banorët e fshatit. Me këtë projekt komuniteti do të ketë mundësi më të mirë të zhvillimit të kulturave bujqësore dhe produkt më të mirë bujqësor. Përfitojnë edhe banorët e fshatrave tjera, pasi që ky kanal ujit edhe fshatrat në afërsi.

Qasja:

Me realizimin e këtij projekti për rregullimin e shtratit të lumit do të shtrohet pjesa e lumit, aty ku ndahet kanali nga lumi, pastaj do pastrohet dhe sipas nevojës do zgjerohet kanali që dërgon ujin në këtë zonë.

3.5 Lagja Llazoviq

Lagja Lazoviq gjendet në pjesën veri-lindore të qytetit të Pejës, e në afërsi të udhë kryqit të magjistrales rrugore që çon për Rozhajë, Mitrovicë e Prishtinë, përball me objektet e Shkollës së mesme ekonomike. Kjo lagje është pjesë urbane e qytetit. Gjithë banorët e saj posedojnë toka pjellore në afërsi, kryesisht në Fushën e Pejës si dhe kullosa dhe male mbi lagje, në malet e afërta. Gjithë banorët e lagjes kanë punuar para luftës në institucionet e ndryshme dhe kjo lagje dallon me arsimim të lartë nga fokus grupet tjera. Për momentin janë të ndërtuara 20 shtëpi e rreth 10 familje qëndrojnë rregullisht këtu në shtëpitë e tyre me nga një apo dy familjarë. Janë të integruar në vend dhe i kanë shfrytëzuar të drejtat e mundshme të tyre që ofron sistemi aktual. Kanë përfituar nga DRC-ja me ndërtimin e shtëpive si dhe me projekt socializues me trajnime dhe vizita të informimit tek institucionet më të rëndësishme për të kthyerit.

Titulli i Projektit: Ndërtimi i objektit për shkollë fillore në lagje

Spektori: Arsim

Kohëzgjatja: 2 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Llazoviq - Pejë

Buxheti: 130.000 €

Qëllimi i projektit:

Te ndërtohet shkolla fillore për klasat nga parashkollor e deri në përfundim të klasës së katërt në dy gjuhë (serbisht dhe shqip) sepse shkollat ekzistuese "Xhemal Kada" dhe "7 Shtatori" i Vitomiricës është e pamundur të gravitojnë nxënësit e lagjes Lazoviq.

Objektivat:

Krijimi i mundësive për shkollim më të mirë të rinjve nga komunitetet
Shtimi i mundësive dhe plotësimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm
Ngritja e nivelit të integritimit të komunitetit serb në gjitha sfera të shoqërisë kosovare
Hapen vendet e reja të punës për të gjithë komunitetet që jetojnë në këtë lagje dhe qytet
Eliminohen rreziku në komunikacion për fëmijët të cilët gravitojnë shkollën në vendet më të largëta

Përfituesit:

Drejtëpërdrejt përfitojnë nxënësit e klasave më të vogla nga të dy komunitetet. Njëkohësisht përfitues do të jenë edhe banorët të cilët kanë kualifikim dhe mundë të punësohen në këtë shkollë.

Qasja:

Në kuadër të këtij projekti do të ndërtohet objekti shkollor i cili do të plotësojë kushtet për nxënësit që nga moshë e parashkollorëve e deri në klasat e 4. Shkolla do duhej të jetë njëkatëshe, me katër klasa, kabinetet shoqëruese dhe sallë të arsimtarëve.

Titulli i Projektit: Vendosja e kontejnerëve për hedhjen e mbeturinave

Spektori: Ambienti

Kohëzgjatja: 3 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Llazoviq- Pejë

Buxheti: 3.000 €

Qëllimi i projektit:

Projekt ka për synim të krijojë një ambient më të pastër në lagje, si dhe të mbroje shëndetin e banorëve të kësaj lagje të banuar me komunitetin serb por edhe nga komuniteti shumicë.

Objektivat:

- Vendosja e kontejnerëve për mbeturina
- Të krijojme një shoqëri më të shëndoshë dhe më të pastër përmes ruajtjes së ambientit dhe pastërtisë
- Pastrimi i lagjes nga banorët e kësaj lagje dhe kryerja e obligimeve ndaj kompanisë së ambientit
- Ofrim i shërbimeve më të mira për mirëmbajtje të ambientit

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë banorët e lagjes Llazoviq të komuniteteve serb dhe shqiptar që jetojnë në këtë lagje. Me vendosjen e kontejnerëve në lagje do të rritet niveli i pastërtisë në lagje si dhe do të krijohen kushte më të mira për jetë në këtë lagje.

Qasja:

Sipas këtij projekti do të vendosen 5 kontejnerë në lagjen Llazoviq, të bëhet pastrimi gjeneral i lagjes dhe të zhduken deponim ilegale të cilat ndodhen në këtë lagje, si dhe të angazhohet kompania për shërbime publike që të ju ofrojë shërbime edhe kësaj lagje e cila është e banuar nga komuniteti serbë dhe shqiptar.

Titulli i Projektit: Asfaltimi i rrugës Llazoviq-Brestovik

Sektori: Infrastrukturë

Kohëzgjatja: 2 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Llazoviq - Pejë

Buxheti: 200.000 €

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim përmirësim e kushteve në infrastrukturë për banorët e lagjes Llazoviq ku kjo rrugë do të mundësonte banorëve të kenë një qasje më të mirë në fshatra të tjera.

Objektivat:

- Krijohet mundësia e shfrytëzimit objektit shkollor ekzistues për komunitetin serb nga kjo lagje në Brestovik.
- Përmirësimi i kushteve për jetë të banorëve të cilët jetojnë dhe për ata të cilët do të kthen.
- Krijimi i kushteve më të mira për kryerjen e punëve bujqësore për banorët
- Përmirësimi i infrastrukturës në viset rurale

Përfituesit:

Të gjithë banorët që jetojnë në këtë lagje dhe banorët e dy fshatrave të tjera të cilat lidhen me këtë lagje njërit përfitues janë edhe komuniteti shqiptarë të cilët jetojnë në këtë lagje. Kjo rrugë është edhe shkurtesë për këto fshatra për të shmang rrugën magjistrale që edhe shkurton rrugën edhe ofron më shumë siguri. Përfitues janë të gjitha komunitet që i përfshin ajo.

Qasja:

Në kuadër të këtij projekti do të jetë e mundur asfaltimi i rrugës në lagjen Llazovic e që ndërlidh dhe fshatra të tjera, po ashtu mundëson edhe shkurtimin e rrugës për në qytet. Rruga që do të asfaltohet është në gjatësinë prej 2 km dhe gjerësinë prej 5 metra, asfaltimi i kësaj rruge do te jetë zgjedhja më e mirë e problemit të rrugës për këta banorë të kësaj Lagje.

Titulli i Projektit: Kuçja e telefonisë fikse në lagjen Llazoviq

Sektori: Komunikim

Kohëzgjatja: 1 vit (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Llazoviq - Pejë

Buxheti: 30.000 €

Qëllimi i projektit:

Furnizimi i banorëve të lagjes me telefoni fikse që do të përmirëson kushtet e jetesës si dhe ofron mundësi tjera si p.sh lidhjet me internet e po ashtu televizionin kabllovik e shumë lehtësime tjera të nevojshme.

Objektivat:

- Pajisja e banorëve me telefona fikse për komunikim me kualitativ dhe me çmime më të lira për kontakte me familjar në Serbi.
- Pakoja e telefonisë fikse ofron edhe mundësit shtesë si p.sh. internetin, televizionin kabllovik me zgjidhje me të madhe kanalesh.
- Lidhje me e sigurt, sepse rrjeti i telefonisë celulare është shumë i dobët dhe i pa sigurt pavarësisht nga origjina e provajderit.

Përfituesit:

Komuniteti i kthyer serb qe jeton në lagjen Llazoviq që përfiton me lidhje komunikacionit telefonik më të mirë dhe më të sigurt si dhe pakove shtesë të përfitimit që ofrohen. Ashtu gjithsesi edhe komunitetet tjera që jetojnë aty e që kanë dëshirat dhe nevojat e njëjta. E po ashtu edhe PTK-ja drejtpërdrejt përfiton me shtimin e konsumatorëve për shërbimet e ndryshme që iu ofron.

Qasja:

Me këtë projekt parashihet shtirja e rrjeti telefonik deri në lagjen Llazoviq. Bëhet fjalë për zgjerim të rrjetit ekzistues të telefonisë edhe për rreth 300 metra në linjën e telefonit deri në qendër të lagjes dhe me këtë mënyrë plotësohet nevoja e komunitetit që një pjesë të familjes e ka në Serbi dhe komunikimi me ta është i domosdoshëm.

Titulli i Projektit: Rregullimi i kanalizimit në lagjen Llazoviq

Sektori: Infrastruktura

Kohëzgjatja: 6 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Llazoviq - Pejë

Buxheti: 100.000 €

Qëllimi i projektit:

Të ofrojë kushte më të mira për banorët e komunitetit që jetojnë në lagjen Llazoviq, si dhe të zgjidh problemin e ujërave të zeza dhe ujërave fekale. Fshatit i mungon një kanalizim kolektiv ku do të mund të derdheshin ujërat e zeza, si dhe do të kyç të gjitha familjet në kanalizimin e fshatit gjë që do të ndikon në ruajtjen e shëndetit të banorëve.

Objektivat:

- Zgjidhet çështja mungesës së kanalizimit në lagje
- Krijimi i kushteve më të mira për jetë të komunitetit me rregullimin e kanalizimit të fshatit
- Kyçja e të gjitha shtëpive në rrjetin e kanalizimit të qytetit
- Mbrojtja e shëndetit të banorëve nga kundërmimi i ujërave të zeza

Përfituesit:

Banorët e lagjes e në veçanti komuniteti serb por edhe komunitetet të tjera të cilat jetojnë në këtë lagje, pasi ende nuk e kanë të zgjidhur problemin e kanalizimit. Po ashtu më kanalizimin ujërave të zeza do të mbrohet edhe shëndeti i banorëve e në veçanti shëndeti i fëmijëve, nga infektimet e mundshme nga kundërmimi i ujërave të zeza

Qasja:

Sipas këtij projekti do të fillojë hapja e kanalizimit në fillim të Lagjes dhe do të vazhdojë deri në kyçjen e kanalizimit të qytetit. Gjatësia e kanalizimit do të jetë diku 3 km, dhe do të shtrihet në të gjitha pjesët e lagjes, duke i lidhur kanalizimet individuale me rrjetin e kanalizimit të përgjithshëm.

3.6 Qyteti i Pejës

Komuniteti serb në qytet është i kthyer në disa lagje, pasi që lagjja e Llazoviqve është fokus grupi i veçantë përqendrimi i të kthyerve është më i madh në pjesën afër lagjes "7 Shtatori", si dhe në të dy rrugët kryesore që lidhin me spitalin kryesor dhe afër qendrës së qytetit. Problematikat më të cilat ballafaqohen ky komunitet në qytetin e Pejës janë të shumta pasi që papunësia është në shkallën më të lartë, ndërsa për tu marrë me bujqësi është e pamundur pasi që ky komunitet nuk posedon as toka bujqësore që do të ndihmonin në krijimin e kushteve më të mira për ta. Ndërsa sa i përket problemit të edukimit kjo është duke ndikuar edhe në kthimin e njerëzve pasi që të gjithë nxënësit janë kthyer në Serbi për të vazhduar mësimet dhe këtu qëndrojnë vetëm për sezonin veror dhe kjo është një ndër problemet me të cilat po ballafaqohet komuniteti.

Me shndërrimin e zanateve në karakter kolektiv dhe inkorporimi në zhvillimin ekonomik institucional është e vetmja mundësi për këtë fokus grup. Problematika kryesore e këtij komuniteti nga zona urbane e qytetit është se mund të llogarisë në kyçjen në vendet publike me kusht që të ketë vende të lira apo me financim me vetiniciativë.

Titulli i Projektit: Ndërtimi i punëtorisë për gurgdhendës

Sektori: Punësimi

Kohëzgjatja: 2 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Pejë

Buxheti: 60.000 €

Qëllimi i projektit:

Projekt ka për synim të ndikojë në përmirësimin e zhvillimit ekonomik dhe zbutjen e papunësisë të komunitetit. Veç kësaj përmes këtij komuniteti ndihmohet mirëmbajtja e varrezave dhe përmendoreve të komunitetit.

Objektivat:

- Bashkimi i mjeteve dhe profesioneve të profileve të ndryshme për dalje në treg pune si strukturë kompatible
- Përmirësimi i kushteve ekonomike në komunitet
- Fuqizimi i komunitetit përmes punësimit dhe krijimi i kushteve më të mira për pavarësimin e familjeve nga të mirat materiale
- Restaurimi i varrezave të dëmtuara dhe të rrëzuara të komunitetit serb

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë banorët e komunitetit serb të cilët jetojnë në qytetin e Pejës e në veçanti ata të kthyerit. Projekti përmirëson pamjen e qytetit dhe ngrit vlerat universale të qytetit.

Qasja:

Me realizimin e këtij projekti së pari do të riparohet objekti i cili është në gjendje të mirë mirëpo nevojiten disa riparime të vogla si dhe pajisja me mjete të punës të cilat do të mundësonin funksionimin e kësaj kompanie e cila do të jetë një bazë e mirë për komunitetin serbë sidomos në zhvillim ekonomik dhe punësim.

Titulli i Projektit: Kultivimi i bimëve shëruese

Sektori: Zhvillim ekonomik

Kohëzgjatja: 2 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Pejë

Buxheti: 30.000 €

Qëllimi i projektit:

Kultivimi dhe përpunimi i luleve dhe bimëve të ndryshme shëruese, nga komuniteti, ku do të ndihmonte në zbutjen e papunësisë dhe fuqizimin ekonomik të disa familjeve, që së bashku do punon në realizimin e këtij projekti.

Objektivat:

- Bashkimi forcës fizike dhe njerëzore nga disa banorë për t'u marrë me kultivimin e luleve dhe bimëve të ndryshme
- Shfrytëzimi i resurseve profesionale dhe fuqi punëtore
- Zbutja e papunësisë për komunitetin serb e sidomos për rastet sociale
- Nxitja dhe promovimi i prodhimtarisë vendore dhe zhvillimit ekonomik të vendit

Përfituesit:

Me këtë projekt direkt përfitojnë disa familje të komunitetit serb që nuk kanë kurrfarë të ardhurave për ekzistencë. Po ashtu përfiton edhe i gjithë komuniteti me këtë prodhimtari, pasurohet tregu me numër të shtuar të produkteve e po ashtu edhe përmirësohet edhe standardi jetësor me çmime më të pranueshme.

Qasja:

Në bazë të këtij projekti banorët do të mbillnin dhe kultivonin bimët mjekësore të bashkuar në një ndërmarrje me strukturat përkatëse menaxhuese. Anëtarë të kësaj ndërmarrje do ishin ata që ofrojnë diçka si psh dijen, mjetet, hapësirën, etj.

Titulli i Projektit: Ngritja e ndërmarrjes për prodhimin e ëmbëlsirave

Kohëzgjatja: 1 vit (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Pejë

Buxheti: 30.000 €

Qëllimi i projektit:

Krijimi i kushteve më të mira ekonomike për komunitetin serb si dhe aktivizimi i grave në këtë mini fabrikë.

Objektivat:

- Përkrahja institucionale e iniciativave të grave nga komuniteti serb dhe sigurimi i ekzistencës së disa familjeve pa të ardhura
- Sigurimi i mirëqenës sociale dhe ekonomike komunitetit serb dhe integrimi i komunitetit serb në gjitha sfera të shoqërisë
- Stimulimi i prodhimtarisë së ushqimit natyral dhe të shëndosh
- Stimulimi i biznesit të vogël si strategji mirëfilltë zhvillimit ekonomik afatgjatë

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti do të jenë familjet e kthyer të cilat janë me qëndrim të përhershëm, ndërsa përfitues më direkt do të jenë gratë nga komuniteti të cilat janë të këqyra në këtë aktivitet.

Qasja:

Do të ndërtohet një mini fabrikë në lokalet ekzistuese që ka komuniteti në Pejë. Projekti parasheh pajisjen me makinerinë dhe linjën e prodhimit dhe aftësimin e kuadrit për punë. Projekti parasheh furnizimin me mjetet e nevojshme për këtë prodhim si dhe aftësimin e kuadrit ekzistues për politikën e re të tregut.

3.7 Fshati Lëvoshë

Fshati Lëvoshë shtrihet 2 kilometra larg Patrikanës së Pejës, në pjesën perëndimore të qytetit buzë Bjeshkëve të Nemuna. Në këtë fshat jetojnë mbi 30 familje, kryesisht të komunitetit serb, të cilat përballen me problematika të ndryshme ekonomike, sociale dhe infrastrukturore.

Në fshat rrugët janë shumë të shkatërruara, mungon ambulanca, e cila do të ju ofronte shërbimet mjekësore më shpejt. Po ashtu aty mungojnë edhe objekte të ndryshme arsimore, kulturore dhe sportive. Kryesisht banorët e këtij fshati jetojnë nga asistenca sociale, dhe pensionale. Në këtë fshat jetojnë persona të moshuar, pasi familjet e tyre vazhdojnë të jetojnë në Serbi që nga viti 1999.

Titulli i Projektit: Riparimi dhe asfaltim i rrugëve të fshatit Lëvoshë

Sektori: Infrastrukturë

Kohëzgjatja: 9 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Lëvoshë-Pejë

Buxheti: 200.000 €

Qëllimi i projektit:

Përmirësimi i kushteve të jetesës së komunitetit të fshatit Lëvoshë kryesisht fshat ky i banuar nga disa pjesëtarë të komunitetit serb. Ky projekt ka për qëllim përmirësim e kushteve në infrastrukturë për fshatin Lëvoshë, dhe kështu të krijojë kushte më të mira për kthim të qëndrueshëm dhe integrim.

Objektivat:

- Krijimi i qasjes më të mirë për banorët të kësaj zone në qytet
- Rregullimi i infrastrukturës rrugore të fshatit
- Sigurimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm i komunitetit serb të fshatit Lëvoshë

Përfituesit:

Përfitojnë banorët e fshatit pasi me asfaltimin e rrugëve të fshatit, do të përmirësohen kushtet e jetës, ofrohen më shumë mundësi në aspektet zhvillimore të ndryshme. Njëkohësisht përfitues do të jenë edhe në aspektin zhvillimit rural dhe ekonomik sepse ky fshat është i njohur me prodhimtari të bujshme të pijeve alkoolike, pemëve dhe perimeve të kualitetit të lartë.

Qasja:

Në kuadër të këtij projekti do të jetë e mundur asfaltimi i rrugës nga fshati Lëvoshë dhe ndërlidhet më rrugët e qytetit e cila është e gjatë 1.2 kilometër dhe e gjerë 3 metra. Po ashtu do të bëhet edhe hapja e rrugëve brenda fshatit Lëvoshë. Më rregullimin e këtyre rrugëve do të krijoheshin kushte më të mira për qasjen e komuniteteve në qytetin e Pejës, si dhe mundësinë e kryerjes së punëve bujqësore nga fshatarët. Po ashtu do të kenë edhe më të lehtë në kryerjen e disa shërbimeve të nevojshme për komunitet.

Titulli i Projektit: Ndërtimi i objekt multi-funksional për fshatin

Sektori: Kulturë, Arsim, Shëndetësi

Kohëzgjatja: 2 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Lëvoshë - Pejë

Buxheti: 200.000 €

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për qëllim ndërtimin e objektit multi-funksional për fshatin Lëvoshë, ku do të realizohen aktivitete të ndryshme kulturore, edukative dhe shëndetësore, ku do të krijonin kushte më të mira për komunitetin.

Objektivat:

- Sigurimi i një objekti për aktivitetet të ndryshme edukim, shëndetësi, kulturë
- Organizimi i ekspozitave të ndryshme, artizanaleve, artikujve bujqësor
- Avancimi i jetës kulturore dhe sportive, mbremje muzikore, organizimin e festave të ndryshme, lojëra shahu, ping pongu, etj.
- Organizimi i seminareve, takimeve të ndryshme më të rinj
- Fuqizimi i grave të komuniteteve përmes kurseve të ndryshme artizanaleve.

Përfituesit:

Të gjithë banorët e fshatit Lëvoshë, grupet e grave burrave dhe të rinjtë dhe fëmijët, po ashtu në kuadër të këtij projekti përfitojnë dhe të tjerë nga fshatra të tjera të cilët mund të jenë pjesë e organizimeve të ndryshme të cilat do të realizohen.

Qasja:

Do të ndërtohej një objekt multi-funksional në fshat, ku në kuadër të këtij objekti do të vendoset edhe ambulanca e mjekësisë familjare, shkolla fillore deri në katër klasë për nxënës e fshatit, po ashtu pjesa e tjetër e objektit do të shfrytëzohet për kulture. Në kuadër të kësaj pjese kulturore do të realizohen aktivitete të ndryshme me gratë, burrat dhe të rinjtë e fshatit Lëvoshë, por edhe të fshatrave për rreth. Objekti duhet jetë 2 katesh me hapësinë 350 metra katrore, dhe do të pajiset me të gjitha mjetet e nevojshme për funksionimin e këtij objekti multi-funksional për fshatin Lëvoshë

Titulli i Projektit: Telefonia fikse në fshatin Lëvoshë

Spektori: Infrastrukturë

Kohëzgjatja: 1 vit (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Lëvoshë - Pejë

Buxheti: 10.000

Qëllimi i projektit:

Hapja e rrjeti të telefonisë fikse në fshatin Lëvoshë. Me futjen e telefonave fikse në fshat përmirësohet kualiteti e jetesës, krijohen lidhje e komunikim me familjet dhe mundësohen lidhjet me internetin shërbime tjera.

Objektivat:

- Pajisja e komunitetit me shërbime të nevojshme të telekomunikacionit
- Përmirësimi i lidhjes telefonike dhe pajisja me shërbime shtesë më të sofistikuar
- Shtimi i infrastrukturës urbane në fshat
- Avancimi i komunikacionit jo vetëm brenda komunitetit por edhe zgjerimit të rrjetit komunikues në favor ekonomik

Përfituesit:

Përfituesit direkt do të jenë banorët e këtij fshati, të cilëve do të iu përmirësohet aspekti i komunikimit, si dhe oferta tjera si interneti e beneficione tjera.

Qasja:

Rrjeti i fshatit do lidhej me telefoninë ekzistuese më qytetin e Pejës. Zgjatja e rrjetit do bëhet për jo më shumë se 500 metra nga vendi deri ku tashmë ekziston rrjeti telefonik në Lëvoshë.

Titulli i Projektit: Ndërtimi i pendave për mbrojtje nga vërshimet

Spektori: Siguri

Kohëzgjatja: 1 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Lëvoshë - Pejë

Buxheti: 10.000 €

Qëllimi i projektit:

Ndërtimi i pendëve të betonit për të ruajtur fshatin e rrezikuar prej ujërave meteorologjike. Nga reshjet e shiut uji del nga shtrati dhe bën vërshime të mëdha dhe shkakton dëme. Këto penda e ndalojnë volumin e ujërave si dhe dheut që ky ujë e merr me vete si erozion i madh dhe rrezik nga i cili duhet të mbrohet po thuaj se i tërë fshati që është i ekspozuar pranë bjeshkës.

Objektivat:

- ? Parandalimi i dëmeve nga vërshimet e ujit meteorologjik.
- Sigurimi i banorëve nga rreziku i erodimit të tokës cilin e nxisin vërshimet e forta dhe të shpeshta.
- Krijimi i kushteve normale dhe sigurta të jetesës të këtij komuniteti.
- Tregimi i kujdesit dhe përgjegjësisë institucionale ndaj kësaj problematike.

Përfituesit:

Përfituesit direkt do të jenë të gjithë banorët e fshatit të cilët do të kenë një siguri më të madhe nga çdo fatkeqësi natyrore dhe nga vërshimet e mundshme.

Qasja:

Duhet të ndërtohen dy panda që do ndalojnë vërshimet e ujit dhe lloqit gjatë ngritjes së nivelit të ujërave. Pendat do ndërtohen në gjatësi 40 metra dhe lartësi prej një deri në 1.5 metra.

3.8 Fshati Brestovik

Fshati Brestovik gjendet në anën veriore të qytetit të Pejës dhe kufizohet me fshatrat Sigë, Lipë dhe Vitomiricë. Brestoviku është rreth 4 kilometra larg pjesës urbane të qytetit të Pejës. Në Brestovik nga janë të ndërtuara 70 shtëpi ku momentalisht ka rreth 100 banorë. Para luftës numri i banorëve të këtij fshati ishte shumë më i madh. Tani në fshat nuk ka të punësuar në institucionet publike dhe kryesisht jetojnë nga të ardhurat sociale si dhe nga ndihma e familjarëve që i kanë në Serbi. Një numër më i madh i këtij komuniteti në këto vite ka filluar të bëjë përpunimin e tokave pjellore dhe të merret kryesisht me bujqësi duke u munduar që të kenë një jetë më të organizuar. Fshati posedon edhe me ujë të pijes të mirë si dhe infrastrukturë të ujitjes të kënaqshme, po ashtu edhe më rrymë është i furnizuar dhe me rrugët e asfaltuara nëpër fshat, kështu që i ka të gjitha predispozicionet për zhvillimin e bujqësisë.

Titulli i Projektit: Ndërtimi i shtëpisë së kulturës

Sektori: Kulturë

Kohëzgjatja: 2 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Fshati Brestovik - Pejë

Buxheti: 50.000 €

Qëllimi i projektit:

Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës në fshat ku do të përmirësoheshin kushtet e jetës së këtij komuniteti sadopak në aspektin kulturor më qëllim të ruajtjes së vlerave kulturore.

Objektivat:

- Aktivizimi i komuniteteve përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme
- Riaktivizimi i jetës kulturore dhe sportive në vend
- Stimulimi për kthimin e të rinjve që është kusht për kthim të qëndrueshëm
- Integrimi i komunitetit përmes aktiviteteve sportive dhe kulturore.

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti do të jenë të rinjtë nga komuniteti i kthyer, po ashtu prindër të tyre, njëkohësisht përfitues do të jenë të gjithë banorët e fshatit, të cilët do të kenë mundësinë e shfrytëzimit të këtij objekti me aktivitete të ndryshme.

Qasja:

Do të ndërtohet shtëpia e kulturës, e cila do të krijojë kushte më të mira për komunitetin në këtë fshat e në veçanti për të rinjtë, që të organizojnë aktiviteteve të ndryshme, ndeja dhe festa të ndryshme. Objekti do ishte njëkatësh me rreth 150 metra katrore, një sallë për takime dhe aktivitete, në zyrë për nevojat e komunitetit. Pajisja me mjetet elementare.

Titulli i Projektit: Ndërtimi i ambulancës së mjekësisë familjare në fshat

Sektori: Shëndetësi

Kohëzgjatja: 2 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Fshati Brestovik - Pejë

Buxheti: 50.000 €

Qëllimi i projektit:

Hapja e Qendrës së Mjekësisë Familjare në fshat, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira shëndetësore për banorët e fshatit Brestovik dhe fshatrave të tjera përreth.

Objektivat:

- Krijimi i kushteve më të mira shëndetësore për komunitetet e ndryshme që jetojnë në këtë fshat dhe fshatrat përreth
- Krijimi i kushteve më të mira për kthim të qëndrueshëm për komunitetin serb, si dhe jetë normale për të gjithë
- Punësimi i disa personave nga komuniteti i kthyer
- Bashkëpunimi ndëretnik dhe tregimi i kujdesit institucional
- Përmirësimi i gjendjes infrastrukturore në pjesën rurale

Përfituesit:

Përfitues do të jenë të gjithë banorët e fshatit Brestovik në veçanti komuniteti serb, gjithashtu përfitues të tjerë janë të gjitha komunitetet tjera të cilët jetojnë në këtë fshatë dhe fshatrat përreth.

Qasja:

Me realizimin e projektit për ndërtimin e qendrës së mjekësisë familjare do të krijohen kushte më të mira të sigurisë shëndetësore jo vetëm për komunitetin e kthyer në këtë fshat, por edhe për banorët të tjerë të cilët do ta kenë më të lehtë qasjen në këtë institucion.

Titulli i Projektit: Shtimi i makinerisë së bujqësisë

Sektori: Bujqësi

Kohëzgjatja: 2 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Fshati Brestovik - Pejë

Buxheti: 20.000 €

Qëllimi i projektit:

Shtimi i makinerisë për punimin e tokave bujqësore, me qëllim që të përmirësohet gjendja aktuale ekonomike dhe të shfrytëzohen pronat private.

Objektivat:

- Furnizohet komuniteti me mjetet e nevojshme për punë, të cilat do të shfrytëzohen kolektivisht për banorët e fshatit.
- Krijohen kushtet minimale për vetëpunësim të qëndrueshëm.
- Përmirësohet gjendja materiale komunitetit mbi të ardhurat materiale.
- Organizimi i jetës dhe punës në formë të duhur dhe frytdhënës.
- Stimulimi i bujqësisë dhe investimi në zhvillim të pjesëve rurale.

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë të gjithë banorët e fshatit Brestovik, njëherit familjet e kthyera të cilat janë më përqendrim të përhershëm në këtë fshatë.

Qasja:

Do të pajisen komuniteti me disa mjete bujqësore kolektive të cilat do të shfrytëzohen në mënyrë të barabartë. Një traktor do të dhurohej për banorët bashkë me pajisjet shtesë. Si do ishte në dispozicion për nevojat e komunitetit.

Titulli i Projektit: Eliminimi i mbeturinave nga tokat pjellore dhe vendosja e kontejnerëve në fshat

Sektori: Ambienti

Kohëzgjatja: 6 muaj (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Brestovik - Pejë

Buxheti: 6.000 €

Qëllimi i projektit:

Projekt ka për synim të krijojë një ambient më të pastër në fshat, si dhe të mbroje shëndetin e banorëve të këtij fshati, si dhe të vetëdijesojë banorët në mirëmbajtjen e ambientit në vendin ku jetojnë, njëherit dhe mbrojtja e tokave pjellore dhe shtëpive të pa banuara.

Objektivat:

- Vendosja e kontejnerëve për mbeturina në fshat
- Të krijojmë një shoqëri më të shëndoshë dhe më të pastër përmes ruajtjes së ambientit dhe pastërtisë
- Pastrimi i deponimeve ilegale më mbeturina dhe largimi i tyre nga tokat pjellore
- Ofrim i shërbimeve më të mira për mirëmbajtje të ambientit.

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë banorët e fshatit Brestovik, më vendosjen e kontejnerëve në fshat do të rritet niveli i pastërtisë në fshat. Kushte më të mira për të jetuar aty e në veçanti shëndet më të sigurt, pasi më vendosjen e kontejnerëve do të largohen mbeturinat nga tokat pjellore, shtëpitë e rrënuar të fshatit dhe deponitë ilegale.

Qasja:

Sipas këtij projekti do të vendosen 8 kontejnerë në fshat, do të pastrohen vendet ilegale, tokat dhe shtëpitë nga mbeturinat që janë krijuar nga vetë banorët e fshatit. Do të angazhohet kompania për shërbime publike që të ju ofrojë shërbim çdo javore për pastrimin e kontejnerëve dhe largimin e mbeturinave.

Titulli i Projektit: Restaurimi i pendëve për mbrojtje nga vërshimet

Sektori: Siguria

Kohëzgjatja: 2 vite (duke filluar nga viti 2009)

Vendi: Brestovik - Pejë

Buxheti: 30.000 €

Qëllimi i projektit:

Restaurimi i pendëve të betonit për të ruajtur fshatin e rrezikuar prej ujerave meteorologjike që me reshjet e ndryshme dhe vërshojnë kah fshati si vërshimet e mëdha nga bjeshkët e afërta ku shkaktojnë dëmtimet e mëdha. Këto panda e ndalojnë volumenin e ujerave si dhe dheut që ky ujë e merë me veti si erozion i madh dhe i rrezikshëm nga i cili duhet të mbrohet po thuaj se i tere fshati sepse është i ekspozuar në fund të bjeshkës.

Objektivat:

- Parandalimi i dëmeve nga vërshimet e ujit meteorologjik.
- Sigurimi i banorëve nga rreziku i erodimit të tokës cilin e nxisin vërshimet e forta dhe të shpeshta.
- Krijimi i kushteve normale dhe sigurta të jetesës të këtij komuniteti.
- Tregimi i kujdesit dhe përgjegjësisë institucionale ndaj kësaj problematike.

Përfituesit:

Përfitues direkt do të jenë të gjithë banorët e fshatit të cilët do të kenë një siguri më të madhe nga çdo fatkeqësi natyrore dhe nga vërshimet e mundshme.

Qasja:

Duhet riparuar tri pendat ekzistuese në brigjet e përroskës së fshatit që ndalojnë vërshimin e ujit. Pendat janë nga betoni me armatura me gjatësi prej rreth 30 metrash secila dhe lartësi deri 1.5 metra. Ato duhen mirëmbajtur rregullisht.

IV. Buxheti



Buxheti

Nr.	Pershkrimi	sasia	koha	sasia ne EUR	Totali EUR
1	Edukim dhe Rini				457,000.00
1.1	Fshati Bellopojë				112,000.00
1.1.1	Restaurimi i objektit shkollor	1	12	8,333.33	100,000.00
1.1.2	Ndërtimi i fushës për futboll të vogël	1	12	1,000.00	12,000.00
1.3	Fshati Gorazhdec				15,000.00
1.3.1	Ndërtimi i një terreni për futboll të vogël	1	9	1,667	15,000.00
1.4	Lagja Llazoviq				130,000.00
1.4.1	Ndërtimi i objektit për shkollë fillore në lagje	1	24	5,416.67	130,000.00
1.6	Fshati Lëvoshë				200,000.00
1.6.1	Ndërtimi i objekt multi-funksional për fshatin Lëvoshë	1	24	8,333.33	200,000.00
2	Punësimi dhe zhvillimi ekonomik				770,000.00
2.1	Fshati Bellopojë				70,000.00
2.1.1	Telefonia fikse në Bellopoj	1	12	833.33	10,000.00
2.1.2	Restaurimi i rezervuarit të ujit të pijshëm	1	24	2,500.00	60,000.00
2.2	Fshati Sigë				10,000.00
2.2.1	Furnizimi i fshatit me serë për perimet	1	12	833.33	10,000.00
2.3	Fshati Gorazhdec				10,000.00
2.3.1	Rregullimi i shtratit të lumit dhe kanalit ujitës	1	3	3,333	10,000.00
2.4	Lagja Llazoviq				330,000.00
2.4.1	Asfaltimi i rrugës Llazoviq- Brestovik	1	24	8,333.33	200,000.00
2.4.2	Kyçja e telefonisë fikse në lagjen Llazoviq	1	12	2,500.00	30,000.00
2.4.3	Rregullimi i kanalizimit në lagjen Llazoviq	1	6	16,666.67	100,000.00
2.5	Qyteti i Pejës				120,000.00
2.5.1	Ndërtimi i punëtorisë për gurgdhendës	1	24	2,500.00	60,000.00
2.5.2	Kultivimi i bimëve shëruese	1	24	1,250.00	30,000.00
2.5.3	Ngritja e ndërmarrjes për prodhimin e ëmbëlsirave	1	12	2,500.00	30,000.00
2.6	Fshati Lëvoshë				210,000.00
2.6.1	Riparimi i rrugëve të fshatit Lëvoshë	1	9	22,222.22	200,000.00
2.6.2	Telefonia fikse në fshatin Lëvoshë	1	12	833.33	10,000.00
2.7	Fshati Brestovik				20,000.00
2.7.1	Shtimi i makinerisë së bujqësisë	1	24	833.33	20,000.00
3	Shëndetësia dhe çështjet sociale				72,000.00
3.1	Fshati Bellopojë				8,000.00
3.1.1	Vizitat mjekësore për banorët e fshatit Bello Pojë	1	36	222.22	8,000.00
3.2	Fshati Sigë				5,000.00
3.2.1	Pastrimi i mbeturinave dhe vendosja e kontejnerëve në fshat	1	6	833.33	5,000.00
3.4	Lagja Llazoviq				3,000.00
3.4.1	Vendosja e kontejnerëve për hedhjen e mbeturinave	1	3	1,000.00	3,000.00
3.7	Fshati Brestovik				56,000.00
3.7.1	Ndërtimi i ambulancës së mjekësisë familjare në fshat	1	24	2,083.33	50,000.00
3.7.2	Eliminimi i mbeturinave nga tokat pjellore dhe vendosja e kontejnerëve në fshat	1	6	1,000.00	6,000.00
4	Anti diskriminimi, siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi				40,000.00
4.6	Fshati Lëvoshë				10,000.00
4.6.1	Ndërtimi i pendave për mbrojtje nga vërshimet	1	12	833.33	10,000.00
4.7	Fshati Brestovik				30,000.00
4.7.1	Restaurimi i pendëve për mbrojtje nga vërshimet	1	24	1,250.00	30,000.00
5	Të drejtat e femrave				23,000.00
5.2	Fshati Sigë				10,000.00
5.2.1	Fuqizimi i grave përmes kurseve	1	12	833.33	10,000.00
5.3	Fshati Gorazhdec				13,000.00
5.3.1	Projekti i emancipimit të grave	1	24	333	8,000.00
5.3.2	Fuqizimi i qendrës së gruas për vet qëndrueshmëri	1	24	208	5,000.00
6	Kultura, Mediat dhe informimi				145,000.00
6.1	Fshati Bellopojë				35,000.00
6.1.1	Ndriçimi i kishës ortodokse në Bellopojë	1	12	416.67	5,000.00
6.1.2	Pajisja dhe funksionimi i shtëpisë së Kulturës në Bellopojë	1	24	1,250.00	30,000.00
6.2	Fshati Sigë				50,000.00
6.2.1	Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës në fshatin Sigë	1	12	4,166.67	50,000.00
6.3	Fshati Gorazhdec				10,000.00
6.3.1	Restaurimi i Shtëpisë së Kulturës	1	24	417	10,000.00
6.7	Fshati Brestovik				50,000.00
6.7.1	Ndërtimi i shtëpisë së kulturës	1	24	2,083.33	50,000.00
					0.00
	Vlera Totale (1+2+3+4+5+6)				1,507,000.00

Parashikimi i buxhetit në këtë pasqyrë financiare i referohet vetëm pjesës së tretë, ndërhyrjes me projekte në komunitet. Pjesa e dytë në të cilat hyjnë iniciativat dhe rekomandimet nuk është buxhetuar, për shkak se autorët e strategjisë mendojnë se këto rekomandime mbesin orientime të vazhdueshme për punën me komunitetin.

V.
Foto







